

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

**INSTALIMI: *SERVIS "RIPARIM E MIRMBAJTJE
MAKINERIVE DHE PAISJE MOTORRIKEE , LYERJE
LLUSTRIM DHE LLUSTRIM MAKINASH***



Investitori: Shoqeria "Briland Line" shpk Tirane

**Adresa: Lagja "Ali Demi", Rruga "Shemsi Haka Njesia Bashkiake
Nr.1. Nd. Nr.218. Bashkia Tirane**

**PERMBLEDHJE JO TEKNIKE I VLERESIMIT TE NDIKIMIT
NE MJEDIS "SERVIS PER RIPARIM MAKINASH E PAISJE
MOTORRIKE, LYRJE E LLUSTRIM MAKINASH" TE SHOQERISE
"BRILAND LINE" SHPK TIRANE**

Permbajtja

1. Hyrje, te dhena mbi Instalimin dhe aktivitetin e tije faqe 2
2. Lendet e para dhe ato ndihmese emergjia e perdorur nga Instalimi..... faqe 22
3. Burimet e shkarkimit nga Instalimi..... faqe23
4. Kushtet ne vendendodhjen e Instalimit dhe rastet e njohura historike te ndotjes. faqe 25
5. Natyra dhe sasite e shkarkimeve te pritshme nga instalimi dhe identifikimi i efekteve te rendesishme te shkarkimit ne Mjedis..... faqe 25
6. Alternativat ne lidhjen me zgjedhjen e vendit te Instalimit, teknologjia e perdorur. Faqe 35
7. Masat per parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve faqe 36
8. Masat per perdorimin eficient te energjise..... Faqe 38
9. Masa te tjere qe rregullojne detyrimet themelore te operatorit..... faqe 38
10. Monitorimi i planifikuar i shkarkimit nga Instalimi..... faqe 40

1. Hyrje

Vendi yne eshte anetar e nje numri konventash nderkombetare, si rrjedhoje eshte i detyruar te zbatoje nje sistem sa me efektiv ne fushat ekonomik-social-mjedisor, per rregullimin e territorit sidomos ne funksion te zgjidhjes se problemeve te ndryshme mjedisore. "Mjedisi eshte burimi i gjithckaje per te cilen njerezit kane nevoje per te jetuar dhe per te zhvilluar".

Tre jane elementet qe nevojiten nje kombi: *njerezit, burimet ekonomike dhe mjedisi* ku jetojne. Keto jane te lidhur shume me njerin-tjetrin dhe nuk bejne dot pa to. Sa me i degraduar te jete mjedisi aq me keq ndikon ne shendetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomik-social. Prandaj duhet nje menaxhim sa me mire i ketyre tre faktoreve.

Etapa e re e zhvillimit e manaxhimit te sherbimeve ka prekur dhe objektin **Servis makinash** sherbim i cila do te jete ne objektin e studimit tone ne aspektin mjedisore qe tashme eshte nje realitet i pa kontestueshem.

Raporti i Vlersimit te ndikimit ne mjedis ka si objekt:

- a) Te mbroje mjedisin.
- b) Krijimin e nje stukture urbane me orientim ekologjik.
- c) Te ruaj burimet natyrore dhe tiparet e peisazhit.
- d) Te ndertoj nje infrastrukture inxhinierike per aktivitetin e studiuar si element baze per mbrotjen e mjedisit.
- e) Marrja parasysh te zonave me karakter historik dhe vecori te spikatura ambientale dhe te peisazhit, duke specifikur vendin ku do te studiojme nga planet lokale, parqe natyrore, zona te mbrojtura.
- f) Elemente qe parashikon normativa ne drejtim te vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM).

Raporti i vlersimit te ndikimit ne mjedis (VNM) te perfshije planifikimin, rehabilitimin dhe masat zbutese te ndikimit te projektit ne mjedis.

Do te paraqesim gjendjen e ndikimit te ketij studimi mbi mjedisin e zones dhe shendetin e njerezve, do te shqyrtojme faktoret pozitiv dhe negativ mjedisore, do te paraqesim skemat e rehabilitimit dhe masat zbutese dhe reduktimin e impakteve negative.

Qellimi i pergatitjes se Raportit te Pernbledhjes Jo teknike te vleresimit te ndikimit ne mjedis.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis te aktivitetit qe zhvillohet eshte hartuar duke patur parasysh kerkesat qe shtron **Ligji "Per mbrojtjen e mjedisit"** etj.

Qellimi kryesor i ketij raporti eshte:

- Te jape informacion per perskrim te vendndodhjes se objektit **Servis makinash**.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
 Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

- Te jape planin e ndertimit, ne perputhje me projektin e rregullimit te territorit te Njesise Administrative Nr.1. Bashkise Tirane
- Te jape identifikimin e vleresimit e ndikimeve te mundeshme te projektit ne mjedisin perreth per aktivitetin qe kryhet, si dhe masat rehabilituese te propozuara, ne rast ndotje dhe demtimi te mjedisit per parandalimin ose zbutjen e tyre.
- Te siguroje qe zhvillimi i ketij aktiviteti nuk ka pasoja negative ne mjedis dhe efekte negative mbi shendetin e punonjesve dhe te komunitetit per rreth.
- Te jape programin e menaxhimit dhe te monitorimit te ndikimit ne mjedis te projektit

Aktiviteti qe kryhet nga Shoqeria « BRILAND LINE » shpk perفشihet ne listen e aktiviteteve qe nuk kane ndikim te fuqishem ne mjedis dhe si rrjedhim eshte pajisur me Leje Mjedisore Tipi C. me numer Leje Mjedise PN-3641-06-2012. Me qense ka ndryshim te bazes Ligjire ku LIGJI Nr. 52/2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR dhe ne baze te urdhrimit te Ministrit te Turizmit dhe Mjedisit Nr. 163 date 16.06.2020 "Per Miratimin e kerkesave te posaçme per shqyrtimin e aplikimeve Per Leje Mjedisi Tipi B, per instalimet ekzistuese te paisura me leje Tipi C te cilat klasifikohen si Leje Mjedisi Tipi B" , detyron Subjektin Shoqerine « BRILAND LINE » shpk te kerkoje paisjen me Leje Mjedisi Tipi B

Baza ligjore

Legjislacioni mjedisor eshte ndertuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te veçante dhe te rendesishem te mjedisit. Keshtu, nder me specifiket mund te përmendim.

Baza Ligjore	
Nr.10431,datë 09.06.2011	Për mbrojtjen e Mjedisit
Nr. 10 440, datë 07.07.2011	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis
Nr. 10 463, date 22.09.2011	Per menaxhimin e integruar te mbetjeve
Nr. 10 448, datë 14.07.2011	Për lejet e mjedis
Nr. 52/2020	"PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR
Nr. 8450, date 24.02.1999	Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre
Nr. 9010 datë 13.02.2003	Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta
Nr. 8094 datë. 24.04.2003	Për largimin publik të mbeturinave I ndryshuar me: - Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009
Nr.9115 datë 24.07.2003	Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura
Nr.8897 datë 16.05.2002	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Nr.9587, datë 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
Nr.8906, datë 6.6.2002	Për zonat e mbrojtura I ndryshuar me: - Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
Nr.10 081, datë 23.02.2009	Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
 Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

Nr.9587, datë 20.07.2006	Per mbrojtjen e biodiversitetit
Nr. 8770 dt 19.04.2001	Per sherbimin e ruajtjes dhe sigurise fizike i azhurnuar
Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për administrimin e zhurmes
Nr. 8766, date 05.04.2001	Per Mbrojtjen nga zjarri dhe per shpetimin
Nr. 8756, datë 26.03.2001	Për emergjencat civile
Nr. 8652, date 31.07.2000	Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore
<i>Ne parlamentin Shqiptar jane miratuar edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit tone ne Protokolle dhe marreveshje te ndryshme. Nder to permendim:</i>	
<u>Ligji Nr. 9672 datë 26.10.2000</u>	<u>Për ratifikimin e konventes se Aarhusit” Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimarrje, si dhe per tiu drejtuar gjykates per ceshtjet e mjedisit</u>
<u>Ligji Nr. 9334 datë 16.12.2004</u>	<u>Për aderimin e Republikës se Shqiperise ne Protokollin e Kiotos” ne konventen per ndryshimet klimatike (UNFCCC)</u>
<u>Ligji Nr. 9424 datë 06.10.2005</u>	<u>Për ratifikimin e protokollit te vleresimit strategjik mjedisor</u>
Vendime te Keshillit te Ministrave	
VKM Nr. 13, date 13.01.2013	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis
Nr. 99, date 18.02.2005	Per miratimin e katalogut Shqiptar te klasifikimit te mbetjeve
Nr. 175 dt 19.1.2011	Strategjia kombetare per menaxh e mbetjeve
Nr. 676, datë 20.12.2002	Për shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror
Nr.804, datë 4.11.2003	Per miratimin e listës se specieve te florës Shqiptare qe vihen ne mbrojtje
Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse
Nr.805, datë 4.12.2003	Për miratimin e listës së veprimtarive që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkohet leje mjedisore
Nr.803, datë 4.12.2003	Per standartet e cilesise se ajrit
Nr.103 datë 31.03.2002	Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë
Nr.435 datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë
Nr.994, datë 02.07.2008	Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
 Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

Udhëzime dhe Rregullore	
Nr. 163 date 16.06.2020	“Per Miratimin e kerkesave te posaçme per shqyrtimin e aplikimeve Per Leje Mjedis Tipi B, per instalimet ekzistuese te paisura me leje Tipi C te cilat klasifikohen si Leje Mjedis Tipi B”
Udhëzim Nr.6, datë 27.12.2006	Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të një veprimtarie
Nr. 3, datë 17. 05. 2006	Udhëzim për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të demtuara nga guroret
Nr.6527, datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre
Nr.5, datë 28.12.2007	Për tarifatat e shërbimit për lejet mjedisore
Nr. 6, datë 27.11.2007	Miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta
Nr. 6527 dt 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis gazet dhe zhurmat I ndryshuar me: - Udhëzimin Nr.12, datë 15.6.2010
Nr.3 date 02.12.2013	Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar Leje Mjedisore te tipit A,B dhe C per aktivitete te reja dhe ekzistuese.
Rregullore Nr. 1, datë 30.3.2007	Trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre

Ne baze te Ligjit nr.10431 dt 9.6.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit”, neni 3 i tij, citojme Objektivat e mbrojtjes se mjedisit.

- a. parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d. përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e. ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f. mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;

Studimi dhe vlerësimi i efekteve mjedisore është një moment i rëndësishëm e ciklit të zhvillimit të një projekti. Studimi mund të kryhet njëkohësisht ose paralelisht me procesin e planifikimit të projektit dhe prezantohet si me vete ose si pjesë e studimit të beshmerise.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

Hartimi dhe zhvillimi i nje projekti te qendrueshem lidhet me kompleksitetin e projektit, menjanimin e streseve mjedisore te mundshme, ndjeshmerine e komponenteve mjedisore te zones ku do te zbatohet dhe masat qe do te ndermerren per mbrojtjen e mjedisit.

Vemendje te vecante do ti kushtohet projekteve qe shkaktoine efekte mjedisore negative te dukshme sic mund te jene ndertimi i impianteve industrial qe shoqerohen me emetime, veprat e infrastruktures (rruge te reja) qe shoqerohen me efekte qe eshte shume e veshtire te identifikohen, efekte qe vijne si rezultat i rritjes se aksesit ndaj burimeve si dhe projekte qe intereferojne me ekuilibrin natyror te natyres. Ne rastet e implementimeve te projekteve te ndryshme me impakte ne mjedis, aspektet me te rendesishme mjedisore qe duhen konsideruar ne zonen ku do te zhvillohet projekti jane:

- Situata aktuale mjedisore dhe evidentimi i ekosistemeve specifike
- Problemet ekzistuese mjedisore dhe gjendja e ekosistemeve te ndryshme ne rast se proejtki nuk zbatohet.
- Përshkrimi i efekteve mjedisore te shkaktuara nga projekti dhe alternativat
- Vlerësimi i stresit te përgjithshëm mjedisor ne te ardhmen
- Nderveprimi i efekteve ekologjike, ekonomike, sociale dhe kulturore
- Rekomandime per alternativa me eekte negative me te ulëta (metoda alternative, kufizimi i emetimeve, ndotjes ne pergjithesi).
- Vleresim te përgjithshëm te situatës mjedisore ne prespektiven e zhvillimit dhe funksionimit te projektit.

Per te bere studimin per zonen mjedisore duhet te bazohemi tek dokumentacioni dhe studimet ekzistuese. Duke stiomuluar vendosjen e projektit ne nje zone te caktuara përcaktohen edhe efektet si bashkëveprim i veçorive te projektit dhe mjedisit qe prekin ciklet natyrore dhe shkaktojnë efekte dytesore social-ekonomike mbi popullatën e rajonit.

Parimet e hartimit te VNM - se

Parimet e mbështetura ne Kreun II te ligjit nr.10431, date 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";

- parimi i zhvillimit te qëndrueshëm
- parimi i kujdesit
- parimi i parandalimit
- parimi "ndotësi paguan"
- parimi i riparimit te dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësimit te mjedisit te dëmtuar
- parimi i përgjegjesisë ligjore
- parimi i mbrojtjes ne shkalle te larte
- parimi i integritit te mbrojtjes se mjedisit ne politikat sektoriale
- parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes se publikut ne vendimmarrjen mjedisore
- parimi i transparencës ne vendimmarrjen mjedisore

"Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm"

- Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të tyre, nxitin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

shoqëror, duke përdorur burimet natyrore në atë mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale dhe të ruhet mjedisi, pa cenuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.

“Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake”

- Masat për mbrojtjen e mjedisit merren në një fazë të hershme të zhvillimit të çdo veprimtarie, në mënyrë që të parandalojnë apo, në rast se nuk është e mundur, të minimizojnë efektet negative të asaj veprimtarie në mjedis.

“Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore”

- Mbrojtja e mjedisit realizohet duke ruajtur njëkohësisht burimet natyrore, përmes kursimit, përdorimit të efektshëm apo zëvendësimit të lëndëve të para natyrore e të materialeve të përfutuara prej tyre dhe ripërdorimit, riciklimit e rikuperimit të mbetjeve.

Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve, brenda kompetencave të tyre, nxitin marrjen e masave dhe kryerjen e veprimtarive për mbrojtjen e burimeve natyrore.

“Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit”

- Masat dhe veprimtaritë e mbrojtjes së mjedisit merren:

a) për të zëvendësuar ndërhyrjet që mund të sjellin efekte të dëmshme mbi mjedisin me ndërhyrje të tjera që paraqesin një rrezik apo kërcënim më të vogël apo kompensojnë efektet e dëmshme të pashmangshme;

b) për të siguruar përdorimin e praktikave më të mira mjedisore, përdorimin e produkteve, të pajisjeve e të aparaturave, si dhe për zbatimin e proceseve të prodhimit, që janë më pak të dëmshme apo të padëmshme për mjedisin.

“Parimi i qasjes së integruar”

- Qëllimi i parimit të qasjes së integruar është parandalimi dhe/ose reduktimi i rrezikut ndaj mjedisit, në tërësinë e tij.

Autoritetet publike, gjatë hartimit dhe miratimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, brenda kompetencave të tyre, marrin parasysh, në mënyrë të veçantë, cenueshmërinë e mjedisit, lidhjen ndërmjet ekuilibrit dhe vlerave të peizazhit natyror, lidhjen ndërmjet burimeve natyrore të përtëritshme dhe jo të përtëritshme, trashëgiminë kulturore dhe të pasurive materiale, tërësinë e ndërveprimeve të tyre të ndërsjella, si dhe ndërveprimin ndërmjet projekteve ekzistuese dhe atyre të planifikuara.

“Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit”

- Bashkëpunimi dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve publike gjatë hartimit e miratimit të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit, programeve, planeve dhe rregullave të ndërhyrjes, dhënies së lejeve të mjedisit apo gjatë zbatimit të politikës, kontrollit dhe masave të tjera mjedisore është i domosdoshëm.

Republika e Shqipërisë siguron bashkëpunimin dhe solidaritetin për zgjidhjen e problemeve mjedisore globale dhe ndërqeveritare përmes marrëveshjeve ndërkombëtare e shkëmbimit të informacionit mjedisor.

Autoritetet publike, brenda kompetencave të tyre, sigurojnë mënyrën dhe kushtet e bashkëpunimit me personat fizikë dhe juridikë, privatë, me qëllim arritjen e objektivave për mbrojtjen e integruar të mjedisit.

Parimi "Ndotësi paguan"

Shoqëria « BRILAND LINE » shpk , veprimet ose mosveprimet e të cilit ndikojnë në ndotjen e mjedisit, mban përgjegjësi financiare, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për dëmtimin e mjedisit. Kosto të tilla përfshijnë kostot e vlerësimit të dëmtimit të mjedisit, vlerësimit të masave të nevojshme, si dhe kostot e shmangies së dëmtimit të mjedisit, përfshirë kostot e rehabilitimit e të kompensimit të personave fizikë apo juridikë të dëmtuar.

"Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut" - Çdo person ka të drejtë t'i jepet në kohë informacion për gjendjen e mjedisit, ndotjen e tij dhe masat e marra, në përputhje me këtë ligj, me legjislacionin të cilit ai i referohet, si dhe me ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit në lidhje me dokumentet zyrtare".

"Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit" - nxitin veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit, që parandalojnë apo reduktojnë ndotjen e tij, si dhe projekte, që ulin përdorimin e substancave të caktuara, të lëndëve të para e të energjisë, apo që e ndotin më pak mjedisin;

mund të lidhin marrëveshje me subjektet ndotëse dhe shoqatat e tyre për masat vullnetare që ato mund të ndër marrin, me qëllim reduktimin e mëtejshëm të ndikimit në mjedis.

Autoritetet publike, fusha e veprimt të të cilave përfshin funksione të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, brenda kompetencave të tyre, nxitin informimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Ne vlerësimin mjedisor çështjet sociale që studiohen lidhen me mënyrën se si ndikohen nga projekti grupe grupe të ndryshme njerëzish, se si ndryshon raporti i tyre me burimet jetesës. Studimi i çështjeve sociale merr rëndësi të vecante në rastet kur ndikohen grupe njerëzish, jeta e të cilëve ndikohet ose kushtëzohet. Komuniteti përbehet nga grupe të ndryshme njerëzish dhe që ndikohen në mënyre jo të njëjta nga përfitimet e zhvillimit të projektit.

1.1. Qëllimi dhe objektivat e zonimit të projektit

Lagja "Ali Demi" për nga permasat i ja kalon për nga numri i popullsisë dhe makinave në përdorim shumë qyteteve që janë kryeqendra të rrethëve përkatëse. Kjo nënjesi Bashkë Nr.1 e Qytetit Tiranë e lidhur me të gjitha nyjet rrugore të Qytetit Tiranë e njohur në gjithë Shqipëri zone me rezultate të mëdha industriale që kohët e fundit është populluar shumë duke u kthyer në një zonë të populluar e ka rritur ndjeshëm fluksin e automjeteve që kalon në këto aks. Periudha e verës është pikë i trafikut. Edhe standarti i jetesës në këto zone ka ardhur vazhdimisht në përmirësim, çka nënkupton edhe një rritje të numrit të automjeteve që posedojnë banorët.

Këto elemente e kanë bërë të domosdoshëm edhe përmirësimin e shërbimit ndaj automjeteve si në çilesi, ashtu edhe në shumëllojshmëri shërbimesh.

Në këto kuader, Shoqëria « BRILAND LINE » shpk ka ideuar ndërtimin e një Autoservis me sipërfaqe të përgjithshme tërësi 65 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 65 m² Autoservis ka 50 m² magazine për pjesët e këmbimit me anë të të cilit ofron për pronarët e automjeteve një pikë të re Autoservisi, duke garantuar standarte të larta shërbimi në këto fushë.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

Qillimi i VNM-se: Te siguroi vlerësimin e përgjithshëm, te integruar dhe ne kohe te ndikimeve mjedisore, te projekteve ose veprimtarive qe kërkojnë te zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative ne mjedis;

Objekti ne shqyrtim eshte ne faze shfrytezimi, ku ne do te fokusohemi ne çështjet me kryesore te aktivitetit te cilat konsistojnë ne:

- Pershkrimin e veprimtarisë se kryer deri me tani.
- Kriteret dhe metodat inxhinierike qe janë zbatuar per ndertimin, mdrichimin, levizje te mjeteve ne Servisin e makinave dhe impjantin e lyerjes se pjesve te tyre.
- Pershkrimi i mjedisit ekzistues
- Ndikimet qe kane prekur mjedisin gjate funksionimit te objektit dhe ndikimet e priteshme.
- Masat dhe investimet qe ka marre Investitori per per ruajtjen e mjedisit ne përputhje me zbatimin e kushteve te Lejes Mjedisore.
- Masat e sigurimit teknik gjate punes

Shoqeria « BRILAND LINE » shpk mer përsipër të ushtrroje veprimtarinë në akord me ligjet në fushën mjedisore, të futura në plane dhe programe të administratave KOMBETARE dhe LOKALE.

Instalimi i një veprimtarie per sherbimin e riparimit te makinave dhe mjeteve motorrike dhe lyerjes e lustrimit te tyre duhet të bëhet sipas kërkesave të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme të vendndodhjes:

- Ne afersi te vendbanimeve urbane, rrugëve te lagjeve e kombëtare dhe zonave me dendësi të lartë të njerëzve; qe tu sherbehet shpajt dhe pa kosto trasporti per perdoruesit e mjeteve motorrike.
- Në territoret gjeologjike të cilat krijojnë pengesa për infiltrimin e mundshëm;
- Larg nga burimet sipërfaqësore e nëntokësore ujore, liqenet/ basenet, pyjet, zonave me ndikim të lartë ekologjik/peisazhistik, zonave turistike, etjer.
- Ku lejohet transporti i vazhdueshëm i automjeteve dhe mekanizmave të tjerë.

Porositsi: Shoqeria « BRILAND LINE » shpk me Numer NIPT K31327072R Tirane Njesia Bashkiake Nr. 1, Lagjja Ali Demi, Rruga Shemsi Haka, Nd. Nr. 218, Zona Kadastrale nr.8180, Nr.Pasurie 6/304/G4 me sipërfaqe 65 m² kerkon te ushtrroje aktivitetin Servis I mjeteve motorrike dhe Lyrje e lustrim te makinave..

1.2. Specifikimet teknike te veprimtarise

Objekti: Servis per rioarimin e mjeteve motorrike e motoçikletave dhe lyerje e lustrim makinash.

Investitori: Shoqeria « BRILAND LINE » shpk

Numri unik i Idintifikimit NUIS (NIPT) K31327072R

Adresa e Shoqerise: Tirane Njesia Bashkiake Nr. 1, Lagjja Ali Demi, Rruga Shemsi Haka, Nd. Nr. 218

Vendendodhja e Objektit: Tirane Njesia Bashkiake Nr. 1, Lagjja Ali Demi, Rruga Shemsi Haka, Nd. Nr. 218

Kategoria e Lejes: Leje Mjedisore Tipi B

Siperfaqe e sheshit te ndertimit: 65 m²

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

Ushtrimi i Aktivitetit Servis per riparimin e mjeteve motorrike dhe lysterjen e lustrimin e makinave do realizohet Brenda teritorit te marre me qera nga Shoqeria « BRILAND LINE » shpk Prone e Z.Luan Çiba. Duke u bazuar ne Ligjin Nr. 10 448, date 14.7. 2011 dhe ndryshimet ligjore te tije me Ligjin Nr. 52/20 "Per disa ndryshime ne alaigjin 10 448 date 14.07.2011 Per Lejet e Mjedisit te ndryshuar. Shtojca 1.

ID. 10.4. Riparim dhe mirmbajtje e makinerive dhe paisjeve motorrike dhe motocikletet;

ID. 7.12 germa g. Lyrje dhe lustrim i makinave klasifikohet ne kategorinë e Lejes Mjedisore Tipi B.

Synimet e hartimit te raportit te Permbledhjes joteknike te VNM-se

Hartimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, synon;

- Vlerësimin e përgjithshëm, te integruar dhe ne kohe te ndikimeve mjedisore, te projektit qe do zbatohet, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative ne mjedis;
- Një proces vlerësimi te hapur dhe te administruar me paanshmëri, nëpërmjet pjesëmarrjes se organeve qendrore e vendore, te publikut, te organizatave jofitimprurëse për mjedisin, te propozuesit te projektit dhe te personave fizike dhe juridike, te specializuar ne këtë fushe.

Hartimi i ketij raporti eshte bazuar gjithashtu ne ligjin per mbrojtjen e mjedisit i cili ne vetvete synon:

- te rregullohet marrëdhënia ndërmjet njeriut dhe mjedisit,
- te mbrojë përbërësit e mjedisit dhe proceset mjedisore
- te sigurojë kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht te pastër
- përdorimin racional te mjedisit dhe kufizimin e shkarkimeve e te ndotjeve ne te, parandalimin e dëmtimit te tij, rehabilitimin dhe shëndoshjen e mjedisit te dëmtuar;
- përmirësimin e kushteve mjedisore, qe lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit te njeriut; ruajtjen dhe mirëmbajtjen e burimeve natyrore, te përsëritshme dhe te papërsëritshme, administrimin racional dhe te frytshëm te tyre;
- bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për te përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;
- bashkëveprimin ndërkombëtar ne fushën e mjedisit;
- nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut ne veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit;
- bashkërendimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror te vendit me kërkesat e zhvillimit te qëndrueshëm;
- ngritjen dhe forcimin e rrejtit institucional te mbrojtjes se mjedisit ne nivel qendror dhe vendor.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
 Instalimi: Servis per riparim makinash e pajise motorike, Iyrje e lustrim i makinave.


1.3. Pershkrimi i Projektit

1.3.1. Vendendodhja e Instalimit


Qarku: Tirane, Bashkia:Tirane, Njesia Administrative: Nr.1. Tirane.

Vendendodhja e Objektivit: Lagjja Ali Demi, Rruga Shemsi Haka, Nd. Nr. 21

Vendendodhja e parcelës ofron pozicion te pershtatshem per zhvillimin e aktivitetit ne funksion te te cilit kerkohej te kryhet ky zhvillim.



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE



Dyqani D-1
sip. 32 m²

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.



1.3.2. Kordinatat ne 4 pikat e kufirit te prones , sipas sistemit koordinativ Gaus Kruger

Pika 1.	X – 403558,59 Y – 4576340,2
Pika 2	X – 403555,28 Y – 4576344,71
Pika 3	X – 403563,47 Y – 4576351,06
Pika 4	X – 403567,92 Y – 4576347,79

Te dhenat jane pasqyruar dhe ne harten e bashkeshoqeruar (KRGJSH)

1.3.3. Te dhena per parcelen ne zhvillim

➤ Te dhena kadastrale

- Çertifikatë pronësie, Nr. 843806, lëshuar nga Z.V.P.P Tirane në datë 24.02.2014
- Zona kadastrale : 8180
- Nr. i pas.: 6/304/G4
- Lloji i pasurisë : Truall
- Sipërfaqja totale : 65 m²

1.4. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

1.4.1. Te dhena mbi plan vendosjen, skema teknologjike dhe kapaciteti riparues te Autoservisit Te dhena mbi plan vendosjen e Autoservisit.

Objekti me siperfaqe te pergjithshme 65 m² ne te cilen eshte ndertuar Autoservisi i makinave me siperfaqe 65 m² gjendet ne Rrugen "Ali Demi " Njesia Bashkiake Nr.1 Tirane ne nje godine 7 katshe servisi ndodhet ne katin e I-re dhe -1

Te dhena mbi skemen teknologjike te Autoservisit te makinave.

Objekti Autoservis makinash dhe distribucion e pare si kompleks ndertimi, perbehet nga:

- | | |
|--|--------------------|
| • Siperfaqja e pergjithshme e prones | 65 m ² |
| • Siperfaqe e Autoservisit | 65 m ² |
| • Siperfaqja e Magazines pjesesh kembimi | 50 m ² |
| • Siperfaqja e parkim te servisit | 100 m ² |
| • Siperfaqja e gjelberimit | 20 m ² |

Te dhenat mbi skemen teknologjike te Autoservisit

Skema teknologjike eshte konceptuar sipas konceptit te riparimit dhe sherbimit ne nje linje me poste te vecanta pune.

Ne kete Autoservis jane keto poste sherbimi dhe riparimi:

- a. Posti i pranimit te mjeteve, per sherbimin e riparimit ku behet kontrolli i mjeteve dhe hartohet preventive i riparimit apo sherbimit.
- b. Posti i nderrimit te vajit, valvolines, filtrave.
- c. Posti i sherbimeve dhe riparimit te te sistemit te drejtimit dhe frenimit.
- d. Posti i sherbimit dhe riparimit te kamiove diferenciale.
- e. Posti i sherbimit dhe riparimit te motorrit
- f. Posti i sherbimit dhe riparimit te sistemit dhe ushqimit dhe sistemit te ftohjes.
- g. Posti i riparimit te sistemit elektrik. (bateri nuk riparohet)
- h. Posti i punimeve te llamarimeve dhe saldimeve.
- i. Posti i lyrjes dhe Ilustrimit te makinave

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

Paraqitja fotografike e pasteve te Autoservisit



Urat e perdorur ne Auto servis

Mjeti pranohet ne hyrje te Autoservisit pasi ploteson kushtet perkatese te hyrjes. Posti i pare eshte procesi i percaktimit te sherbimit ose riparimit qe do ti kryhet mjetit, ku plotesohet urdheri i punes. Mjeti pastaj çvendoset ne vendin e sherbimit ose riparimit ku i kryhen sherbimet e percaktuara ne urdherimin perkates. Sipas sherbimeve dhe riparimeve te percaktuara ne urdherin e punes fillon puna. Kur kryhet sherbimi i nderrimit te vajit, valvolines dhe filtrave te gjitha vajrat qe hiqen grumbullohen ne ene te mbyllura dhe me pas dergohen per perpunim. Po ashtu dhe filtrat dhe pjeset e tjera qe hiqen grumbullohen ne vende te posacme ku merren dhe dergohen ne vendet e grumbullimit dhe dekompozimit.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

Kur kryhen riparime behen zmontime te te gjitha pjeseve qe do te zevendesohen duke i derguar ne vendet e percaktuara kurse pjeset qe do te vihen perseri ne pune lahen ne vaska te vecanta pastrohen thahen dhe rivendosen perseri.

Pervec sherbimeve dhe riparimeve te nyjeve motorrike e xhenerike ne kete raport behen dhe punime llamarine te cilat dhe keto jane konceptuar ne nje linje me poste pune ku fillohet me drejtimet, saldimet, stukimet dhe lyerjet.

1.4.2. Ne Autoservisin qe do ndertohet do vendosen keto paisje:

2. Ura ngritese per autoveturat 2.5 deri 4 ton cope 2
3. Bankprove diagnostikuese motori cope 2
4. Bankprove frenasi cope 1
5. Kompjuter per diagnostikimin e difekteve ne automjete. cope 1
6. Bankprove per dinamo-motorrino cope 1
7. Pajisje per repartin baterist komplet 1
8. Bankprove per sistem ushqimi cope 1
9. Pajisje per repart gomist komplet 1
10. Paisje per lyerjet dhe llustrimin e makinerive
11. Magazine e kompletuar me pajisje nderrimi origjinale per mjete te te gjitha llojeve .
12. Magazine per mbajtjen e pjeseve te nderrimit te perdorura.
13. Magazina me vajra lubrifikant original te markes Elf 10 m²

Ne kete shesh investitori ka ndertuar dhe keto objekte:

- ❖ Zyrat
- ❖ Paneli komandues
- ❖ Nyjet sanitare per personelin
- ❖ Gordrobe per punonjesit dhe personelin inxhinjerik
- ❖ Parkim
- ❖ E tj.



Grumbullini i pjesve te hequra nga riparimi i makinave.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.



Paneli i lyerjes dhe lustrimit

Lyerja e makinave nenkupton lyerjen e te gjitha pjeseve te makinave qe mund te jene demtuar aksidentalisht apo edhe lustrimin e tyre. Subjekti ben te mundur lyerjen komplet te nje pjese te makines duke perfshire ketu:

- Lyerjen e parakolpeve
- Lyerjen e prapakolpeve
- Lyeden e dyerve

Ne ambientin ku zhvillohet aktiviteti ka hapsira per levizjen e mjeteve qe vijne per lyerje, njerezit qe punojne ne kete subjekt sistemojne oborrin per automjetet qe do ti nenshtrohen procesit te mevonshme te lyerjes.



Paneli i mbajtjes te gomave te reja dhe atyre qe nderrohen

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

Teknologjia qe do te perdoret ne Autoservisin e makinave eshte moderne dhe bashkekohore. Makinerite e linjes qe jane instaluar jane te teknologjise se fundit, prodhim italian.

Lenda e pare si pjeset e nderrimit, vajrat lubrifikante, bojrat per lyrje dhe gomate te gjitha llojeve per markat e makinave qe riparohen ne kete Autoservis vijne te gjitha nga importi dhe jane i nje cilesie ekstra.

1.4.3. Te dhena mbi kapacitetin riparues te Autoservisit te makinave do te jete:

Ky Autoservis sipas dimensioneve dhe posteve te punes qe ka, ka mundesi praktike qe te kryeje sherbime te ketij numri mjetesh.

1. Sherbimet e nderrimit te vajit te valvolines dhe filtrave rreth 20 mjete ne muaj.
2. Riparime te sistemit te drejtimit, frenimit rreth 10 mjete ne muaj.
3. Riparime te sistemit elektrik rreth 10 mjete ne muaj.
4. Riparimi i sistemit te ftohjes rreth 10 mjete ne muaj.
5. Riparime te kamiove dhe diferencialeve rreth 5 mjete ne muaj.
6. Riparime te motorreve 2 mjete ne muaj.
7. Riparime llamarine stukime dhe lyrje 5 mjete ne muaj.

Linja e instaluar ne Autoservisin e makinave eshte zgjedhje e makinerive te reja te importuar nga Italia.

1.4.4. Pershkrimi i instalimeve qe bejne pjese ne projekt:

Lidhja e objektit me infrastrukturen inxhinierike:

Energjia elektrike

Furnizimi me energji elektrike per objektin Shoqeria « **BRILAND LINE** » shpk e ka siguruar nga nje gabin 20kw. qe ndodhet ne afersi te objektit. Brenda objektit nuk kalojne linja elektrike qe jane ne vartesi te filialit elektrik te Qarkut Tirane.

Furnizimi me uje

Furnizimi me uji per objektin Shoqeria « **BRILAND LINE** » shpk e ka realizuar nepermejet sistemit te ujsjellsit te Nen'njesise BashkiakeNr.1. Bashkia Tirane ujsjelles i cili eshte ne kapacitet te plote dhe per kete objekte. Ne siperfaqen ku eshte ngritur Autoservisi nuk kalojn linja te UKT

Rrjeti telefonik

Sipas azhonimit ne terren qe ka realizuar Albtelekom ne zonen e percaktuar ka rrjet telefonik.

Kanalizimet e ujrave te zeza

Nuk lind nevoja per krijimin e nje rrjeti te ujrave te zeza, pasi ka rrjet te kanalizimeve te ujrave te zeza i cili lidhet me kolektorin kryesore te Nen'njesise BashkiakeNr.1. Bashkia Tirane .

Sheshi eshte i rrethuar ne kufijte e vete, te percaktuar ne planimetrine e vendosjes se Autoservisit.

1.4.5. Te dhena teknike te aktivitetit

ID 10.4 Riparimi dhe mirembajtja e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motocikletave nqs nuk jane permendur dikur tjeter ne kete shtojce.

ID 7.12, germa g. Lyrja dhe lustrimi i makinave.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

Aktiviteti qe ushtron Shoqeria « **BRILAND LINE** » shpk eshte shërbimi për automjete autoservis. Ne kete pike servisi, proceset e punes kryhen sipas nje radhe te caktuar. Makina, motorri apo mjete tjeter motorrik qe do te kontrollohet, i nenshtrohet disa kontroleve nga ana e xhenerikeve te punesuar ne kete subjekt, duke filluar qe nga:

Kontroli Visual (kontrolli fizik) me sy

Sisteme dhe pjesë që kontrollohen vizualisht në automjetet e ardhura ne kete servis janë:

- Sistemi i ndriçimit dhe sinjalistikës së jashtme,
- Gjendja e të gjitha gomave dhe rrotave,
- Kroskoti i automjetit dhe funksionimi i tij,
- Fshirëset dhe larëset e xhamave,
- Sistemi elektrik,
- Të gjithë elementet që lidhen me sistemin e frenimit (pedalet, levat, tubat etj.)
- Të gjithë elementet që lidhen me sistemin e drejtimit (nyjet, gominat etj.)
- Funksionaliteti dhe siguria e dymve, dritareve dhe pasqyrave,
- Ndenjëset dhe funksionimi i rripave të sigurimit,
- Gjendja e shasisë së automjetit,
- Konsumim jo i rregullt i pneumatikëve,
- Kauçuki i pastrueses së xhamit te dëmtuar.
- Xhamat e fenereve dhe të dritave të dëmtuara.
- Pasqyrat e lira.
- Antena e këputur
- Rrjedhje në motor.
- Rrjedhje në sistemin e shkarkimit
- Pllakat e frenave të konsumuara
- Niveli i rezervuarit.
- Aksesorët që mungojnë ose janë të dëmtuar.
- Rrota rezervë që mungon.
- Dëmtime të karrocërës që klienti nuk dëshiron ti riparojë.

Pasi eshte bere kontrolli visual, mjete motorrik, automobili, makina apo motorri kalon ne **Kontrollin teknik me pajisje diagnostifikuese**, nje metode kjo e perdorur per te identifikuar difektet qe ka rritur shkallën e besueshmërisë tek klientët dhe ka përmirësuar cilësinë e fazës së kontrollit të automjetit. Programet kompjuterike të kontrollit përditësohen sa herë kompania e prodhimit të automjetit nxjerr një model të ri të markës përkatëse.

Ky lloj kontrolli konsiston kryesisht ne:

- Diagnostikim i defektit me aparaturë kompjuterike.
- Diagnostikim në banko-provë për sistemet e frenimit, drejtimit dhe amortizimit.

Disa nga proceset e mirembajtjes qe kjo pike servisi ofron jane:

- Zëvendësimi i vajit te motorrit dhe filtrit të vajit, të filtrave të karburantit, filtrit të ajrit

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

dhe filtrit të kabinës ne bazë te kilometrave te pershkruara nga automjeti dhe percaktimi i ndërrimit të rradhes.

- Testimi dhe zevendesimi i vajit te frenave, plotesimi i nivelit të depozites së vajit të frenimit.
- Kontrolli i sistemit të frenimit, zëvendësimi i ferrodave dhe disqeve te konsumuara, regjistrimi i frenave te këmbës dhe të dores.
- Kontrolli i sistemit të ndezjes dhe plotesimi i nivelit të elektrolitit ne akumulatorin e motorrit, zëvendësimi i kandeleve ne automjetet me benzine dhe gaz ne bazë të kilometrave të pershkruara.
- Kontrolli i presionit te ajrit të gomave dhe rregullimi i ketij presioni ne nivelin e rekomanduar nga xheneriku.
- Pergatitja e antifrizes ne parametrat e duhur ne sistemin ftohes te motorrit.
- Kontrolli i sistemit të kondicionimit të ajrit dhe zëvendësimi i gazit ftohes pas testimit të tij.
- Vendosja e sinjalizuesve dhe ndricuesve te demtuar dhe kontroll i detajuar i sistemit te sinjalizim-ndricimit.
- Kontrolli i kutisë së shpejtësisë dhe i diferencialit për nivelin e vajit dhe plotësimi i tij në raste nevojë.

Me Sherbim Teknik te mjeteve motorrike do te konceptohet teresia e operacioneve teknike qe kryhen ne to, te parashikuara qe me pare ku hyjne: pastrimi, larja, shtrengimet e ndryshme punimet e regjistrimeve te detaleve dhe të mekanizmave te ndryshem, kontrolli i nyjave dhe i mekanizmave, grasatimi, kontrolli i nivelit dhe nderrimi i vajit ne motor, kontrolli i nivelit të vajit ne kutinë e shpejtësisë diferenciale etj. Nepermjet ketyre operacioneve zbulohet ne kohe dhe parandalohet lindja e çrregullimeve te ndryshme nga njera ane dhe nga ana tjetër zvogelohet konsumimi i detaleve duke menjanuar shkaqet qe e pershejtojne kete konsumim.

Sherbimi Teknik bazohet

➤ **Në mirëmbajtjen e përditshme (MP)** ku duhet të kryhen këto veprime:

1. Kontrolli i gjendjes teknike të automjetit. Ky kontroll ka për qëllim që të sigurojë lëvizjen pa rrezik të automjetit në rrugë.
2. Furnizimi i automjetit me materialet shfrytëzuese (lëndën e djegëshme, lëndët lyrësuese (vajosëse), lëndët ftohëse, lëndët frenuese etj), që të sigurohet puna normale e tij.
3. Sigurimi i një pamjeje të jashtme të rregullt të automjetit. Për këtë qëllim mirëmbajtja e përditshme e automjeteve kryhet çdo ditë.

Në punimet e mirëmbajtjes së përditshme hyjnë:

1. Punimet e kontrollit të gjendjes dhe të veprimit të mekanizmit të drejtimit (sistemit të drejtimit dhe sistemit të frenimit), nga puna e të cilëve varet siguria e lëvizjes.
2. Aparatet e ndriçim-sinjalizimit, të karrocërisë dhe kabinës.
3. Kontrolli dhe korrigjimi i nivelit të vajit në motor dhe në agregatet e tjera (shtohet vaj për këta mekanizma duke arritur në nivelin e duhur).

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

4. Kontrolli i nivelit të ujit në sistemin e ftohjes.
5. Mirëmbajtja e përditshme kryhet çdo ditë nga vetë drejtuesi i mjetit. Shoferi në çdo çast vron me kujdes mjetin që drejton, degjon gjithmonë punën e agregateve kryesore të automjeteve.

➤ **Gjatë shërbimit teknik 1 (SHT-1)** kryhen këto veprime:

1. Kontrolli i jashtëm teknik i të gjithë automjetit.
2. Kryerja e një vëllimi të caktuar të punimeve të kontrollit, të shtrëngimit, regjistrimit, vajosjes, punimeve elektrike dhe furnizimit.
3. Kontrolli i punës së motorit, i mekanizmit të kthimit, të frenimit dhe i mekanizmave të tjerë në lëvizje.

Punimet e shërbimit teknik 1 kryhen pa bërë çmontimin e nyjeve dhe agregateve të ndryshme të automjetit.

➤ **Gjatë shërbimit teknik 2 (SHT-2)** kryhen:

1. Kontrolli më i thelluar i gjendjes teknike të të gjithë mekanizmave dhe aparateve të automjetit. Për këtë qëllim aparatet e ushqimit dhe aparatet e sistemit elektrik hiqen nga automjeti dhe kalojnë për kontroll në repartet e kontroll-regjistrimit të tyre.
2. Kontrolli i agregateve, mekanizmave dhe aparateve të automjetit në lëvizje e sipër.

Me Riparim te Automjeteve do te kuptojme evitimin e defektit te konstatuar duke ndërruar te gjitha pjeset e konsumuara e te demtuara dhe rikthimin ne pune te automjetit me parametra normale te gjithe agregateve perberes te tij.

Paisjet dhe veglat e punes që perdoren në kete servis janë të shumta duke filluar nga ato më të thjeshtat deri tek ato speciale për automjete të caktuara, kjo dhe në varësi të madhësië së servisit dhe te llojit të shërbimeve që ky do të ofrojë. Ne pajisjet kryesore vlen te permendim:

Vinçi (Lifti)

Roli i vinçave në servis është jetik për çdo specialist, për kontrollin e te gjitha pjeseve xhenerike, per zevendesimin e tyre, per montimin dhe cmontimin e te gjitha pjeseve qe jane te lidhura me shasine e motorrit. Ka shumë lloje të vinçave që perdoren ne servise duke u klasifikuar ne baze te peshengritjes dhe menyres se kapjes se tij me shasine se tyre.

Kompresor ajri

Shërben për prodhimin e ajrit të ngjeshur që përdoret ne disa paisje të servisit. Kompresori zgjidhet me kapacitet te ndryshem, p.sh 200L, 300L, 500L etj. ne bazë të nevojave për ajër ne servis të llogaritura me pare, ne varesi te punes dhe te numurit të paisjeve pneumatike që do të përdoren në servis.

Grumbullusi i vajit

Shërben per zëvendesimin e vajit ne automobil. Eshte grumbullues me vetërrjedhje vaji dhe pneumatik. Në rastin e grumbullusit pneumatik ai është i paisur me disa tuba thithës te cilat

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

përshtaten me tubat ekontrollit të nivelit të vajit dhe nëpërmjet vakumit që krijon paisja bëhet e mundur nxjerja e vajit nga motori.

Presë Hidraulike

Kjo presë shërben për çmontimin dhe montimin e kuzhinetaves, bokollave të ndryshme dhe gominave që gjendenyjet the agregatet e motorrit. Perdorimim i kësaj pajisje ben të mundur montimin sipas kushteve teknike te detaleve me shtrengim.

Pajisje diagnostifikuese

Nëpërmjet pajisjes diagnostifikuese diagnostikohen difektet e shfaqura ne automjet tek te cilat nje pjesë e sistemeve te ndertimit te tyre komandohen nga paketa elektronike nëpërmjet skemave te ndryshe elektronike. Kjo realizohet nepërmjetë kompjuterave speciale dhe programeve perkatese per secilin tip qe e lejon nje diagnostifikim te tille, programe qe prodhohen per cdo seri prodhimi te tipeve te ndryshme automjetesh.

Keto paisje mund te jene stacionare ose portabile. Me pajisjen më inovative të teknologjise diganostike ofrohet përcaktimi universal i diagnozëns. Kjo paisje është e njëjtë per shumë markat dhe iu përshtatet këtyre markave te njohura nëpërmjet softeerave përkatës, duke kursyer në këtë mënyrë aparatet e shumta që mund te përdornim për secilën marke.

Kutia e ndihmes se shpejte

Nje nder pajisjet e rëndesishme te perdorura ne kete servis eshte edhe kutia e ndihmes se shpejte, e cila eshte e vendosur ne nje vend te caktuar ne ambjentet e ketij subjekti. Funkzioni i saj eshte te ndihmoje punonjesit ne raste lendimi, plagosjeje apo aksidentesh te papritura gjate proceseve te punes.

Subjekti gjate ushtrimit te veprimtarise se tij dhe per kryerjen e proceseve te punes perdor lende te para sic jane pjeset per makina e motorra te tilla si ferrotat, disqet, kushinetat, pompat e filtrat e ajrit, vajit e naftes. Nder lendet ndihmese te perdorura gjate kryerjes se proceseve te punes permenden lubrifikantet e llojit e markave te ndryshme, si: vajra motorri e hidraulike.

Per sa i perket aktivitetit te lyerjes subjekti do te perdore teknologji te perparuar e cila ben te mundur emetimin e ulet te aromave apo cdo substance tjeter te rrezikshme. Lyerja kryhet ne nje dhome te vecante te izoluar me qellim ruajtjen e mjedisit. Ky proces do te kryhet me pompe, siperfaqe e nxjerrjes se bojes shkon direkt ne siperfaqen e pjeses qe do te lyhet. Ky proces shoqerohet pa shkarkime.

2. Lendet e para dhe ato ndihmese emergjia e perdorur nga Instalimi

2.1. Pjeset e kembimit qe perdor Servisi

- Pjese kembimi mororrike per riparimin e motorrve dhe motoçikleta
- Pjese gjemerike.
- Pjese kembimi elektrike.
- Vaj per nderrimin e vajit te motorrit dhe te frenave.
- Bojra per lyerjen dhe ilustrimeve e makineve.

2.2. Materjalet ndihmese

- Aksesore ndihmes per riparimet, motorrike, gjenerike dhe elektrike si
- tuba,
- fiye kabulli elektrik.
- Celsa te permasave te ndryshmeetjer

2.3. Energji elektrike

Energjia elektrike perdoret per venjen ne pune te te gjith paisjeve te servisit

- Tipi : Energji elektrike
- Sasia: 300 kw/muaj
- Burimi : OSHE shperndarje Tirane

2.4. Uje.

Uji perdoret per larjen e pastrimin e pjeseve te kembimit te hequra dhe per nyjen sanitare te servisit.

- Sasia 0,5, m³ ne dite
- Burimi UKT Tirane

3. Burimet e shkarkimit nga Instalim

Ndikimet e mundeshme ne mjedis dhe masat e propozuara per zbutjen dhe parandalimin e tyre

3.1. Nkimet pozitive te aktivitetit

- Krijimi i mundesive te punesimit te rreth 5-6 punonjesve
- Siguron cilesi ne mirmbajtjen e makinave
- Aktivitetet nuk do te kete ndikime negative ne mjedis. Ai nuk krijon mbetje.
- Objekti ka infrastrukture te gateshme, ndodhet ne anen e djathte te rruges se **Ali Demi**

3.2. Ndikimet negative ne mjedis i aktivitetit

- Nga ky aktivitet nuk parashikojme shkarkime te ndryshme ne burimet ujore.
- Linja e Autoservisit te makinave do perdori si lende te pare pjese kembimi,vajra lubrifikante,goma e materjale te tjera te sjella nga importi vetem nga vende perendimore.
- Ndikim me i rendesishem mund te jete fenomeni i ndotjes se ajrit si rezultat i ngritjes se pluhurit ne atmosfere erozionit, krijimi i mbeturinave te vajit e zhurmave nga makinerite dhe te transportit perbrenda mjedisit e objektit.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

- Per zhurmat qe do krijohen brenda mjediseve te punes puntoret jane instruktuar te mbajne mjetet mbrojtese te tyre (kaska) ndersa per banoret e zones shtepite e te cilene jane larg nuk do te kete ndikime.

3.3. Shkarkini nga Instalimi Servis

3.3.1. Mbetjet e ngurta.

Mbetjet e ngurta perftohen nga te gjitha proceset e punes qe ofrohen, si ai motorist, xhenerik, elektroauto. Si ne te gjitha Autoserviset perqindjen me te madhe te ketyre mbetjeve do ta zene filtrate e vajit, filtrat e ajrit, rrypat e motorreve, kamat e motorreve, pjese te demtuara si permistop, kuzhineta, akse te vogla.

Pjeset e medha si, amortizoret, sustat, testatot, rastet e grupit te motorrit, kamjes do te vendosen ne nje ndarje metalike per tu evaduar me makine ne vend depozitimin e mbetjeve urbane, ose per tu shitur neper fonderi. Ne mbeturinat bejne pjese edhe ambalazhet e pjeseve te nderrimit, qe kryesisht jane leter, plastike e me rralle polisterol. Per kete eshte caktuar edhe vendi i grumbullimit te tyre.

3.3.2. Mbetjet e lengeta.

Vaji i nderruar i motorreve pasi terhiqet nga nje pajisje bashkekohore depozitohet ne bidona kauçuku dhe me pas tregetohet per subjekte private qe e perdorin ate per trajtimin e lendes drusore per ndertim.

Brenda 1 muaji, parashikohet te depozitohen afersisht 10 - 30 litra vaj.

Ujrat e perdorura e te ngarkuara me vajra e tretesa lares do te trajtohen ne vaska dhe depozitohen ne bidona.

Shoqeria « **BRILAND LINE** » shpk do te ndertoje ndertimi i separatorin ndares.

3.3.3. Ndikimet ne ajer.

Ndikimet ne ajer jane te pa perfillshme. Produktet e djegjes se karburantit gjate qarkullimit e manovrave jane te zakoneshme dhe punojne si te tilla vetem ne mjedise te hapura jashte. Perqendrimi i ketyre emetimeve eshte normal, i krahasueshem me nje mjedis te tille te hapur.

Gjate aktivitetit nuk ka asnje proces tjeter shkarkimi ne ajer

3.3.4. Zhurmat.

Per shkak te hapsires dhe afersise me rrugen edhe zhurmat jane te paperfillshme. Ato shkaktohen kryesisht prej motoreve te automjeteve gjate provave ne sherbim. Por, duke patur parasysh se ne repart punohet me më shume se nje motor, gjithnje emetuesi i zhurmes duhet te percaktohet se cilit mjeti i perket. Zhurmat e tjera jane ato te *ardhjes dhe largimit* te automjeteve. Duke patur parasysh kapacitetin e repartit zhurmat i konsiderojme te pranueshme dhe nuk ndikojne potencialisht negativisht ne pragun normal te ndijimit te njerezve.

Keshtu nuk perben ndonje problem per banoret.

Vendosja e repartit ne nje pike te populluar lehteson ndikimin e ketij sherbimi tek njerezit.

3.3.5. Ndikimi ne infrastrukturen urbane te zones.

Ky objekt nuk ka ndikuar ne asnje element te infrastruktures se zones si rruge, kanale kulluese e ujtese. Ky aktivitet nuk shoqerohet me rritjen e qarkullimit ne nje segment te caktuar rrugor sepse lidhet direkt me rrugen ALI Demi Tirane dhe zbatohen parametrat teknik te largesise dhe te hyrje daljeve ne te.

3.3.6. Perputhshmeria me planin urbanistik rregullues te zones.

Zona ne fjale nuk eshte e trajtuar me nje plan rregullues perspektiv, dhe aktualisht nuk ka ndonje plan zhvillimi. Projekti ne fjale nuk i bie ndesh perspektives se zhvillimit te zones.

4. Kushtet ne vendndodhjen e Instalimit dhe rastet e njohura historike te ndotjes

Shoqeria « BRILAND LINE » shpk mer persiper te ushtroje veprimtarine ne akord me ligjet ne fushen mjedisore, te futura ne plane dhe programe te administratave KOMBETARE dhe LOKALE.

Instalimi i nje veprimtarie per sherbimin e riparimit te makinave dhe mjeteve motorrike dhe lysterjes e lustrimit te tyre duhet te behet sipas kerkesave te vleresimit te ndikimit mjedisor dhe duke marrë ne konsiderate kriteret e mëposhtme të vendndodhjes:

- Ne afersi te vendbanimeve urbane, rrugëve te lagjeve e kombëtare dhe zonave me dendësi të lartë të njerëzve; qe tu sherbehet shpajt dhe pa kosto trasporti per perdoruesit e mjeteve motorrike.
- Në territoret gjeologjike të cilat krijojnë pengesa për infiltrimin e mundshëm;
- Larg nga burimet sipërfaqësore e nëntokësore ujore, liqenet/ basenet, pyjet, zonave me ndikim të lartë ekologjik/peisazhistik, zonave turistike, etjer.
- Ku lejohet transporti i vazhdueshëm i automjeteve dhe mekanizmave të tjerë.

Shoqeria « BRILAND LINE » shpk ushtron aktivitetin ne Servisin e makinave qe ne Qershore 2012 prej keti viti nga ky Instalim nuk ka pasur raste te njohura ndotje te Mjedisit ne brendesi te instalimit e zones perreth vendit ku funksionon Instalimi.

5. Natyra dhe sasite e shkarkimeve te pritshme nga instalimi dhe identifikimi i efekteve te rendesishme te shkarkimit ne Mjedis

5.1. Pershkrim i mbuleses bimore.

Zona ne te cilen eshte ndertuar Instalimi eshte zone urbane per ndertim. Mbulesa bimore e zones eshte me bimesi te kultivuar. Per bimet e kultivuara perdoren grupime te ndryshme. Kriteret kryesore qe zbatohen per grupimin e tyre bazohen ne vecurite botanike, jetegjatesine (bime nje, dy dhe shumevjeçare) reagimin foto periodik, vecurite agronomike, qellimin kryesore te perdorimit.

Sejcili prej kriterëve te mesiperma eshte i domosdoshem per tu patur parasyshe kur kerkohet te vihen anë te veçanta te morfologjiose, biologjise, kerkesave ekologjike te bimve etjere.

Rajoni i marre ne studim karakterizohet nga nje shtrirje e madhe me vecori hapesinore te perceptimit dhe bashkesise se komuniteteve urbane dhe natyrore, te cilat sherbejne per evidentimin e hapsirave baze.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

Siperfaqja qe i eshte nenshtruar shfrytezimit ka qene toke Urbane. Ushtrimi i aktivitetit ne kete siperfaqe, nuk ndikon negativisht ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore sepse toka e kesaj zone e ka koeficientin e humusit te ulte dhe pak acid e cila çon ne nje rendiment te ulet te kesaj zone per kultivime bujqesore me kapacitet te lart.

Mbulesa bimore ne teritorin ku eshte ndertuar Instalimi thajse nuk ekziston pasi ky teritore prej vitesh eshte perdorur si toke truall dhe mbi te eshte ndertuar dhe vazhdojne te ndertohen Siperfaqja ne fjale eshte perdorur si vend parkimi makinerishe duke eleminuar bimesine ekzistuese ku e vetmja bime qe rritej ne kete vend eshte xunkthi dhe disa bime decorative si Liguster, rrapit etj.

Nje nder veçurite e keti projekti eshte dhe hartimi I nje projekti per gjelberimin e kesaj siperfaqe me gjelberim si me bime te larta dhe te ulta.

5.2. Burimet Ujore

Tirana ka burime të mjaftueshme ujore për tju përgjigjur kërkesave aktuale dhe perspektive. Kryeqyteti furnizohet, nga katër burime uji sipërfaqësore dhe rreth tetë burime nëntokësore. Burimet sipërfaqësore mbulojnë rreth 50% të furnizimit në vitet e thata, e deri në 80% në vitet e lagështa. Rezerva aktuale e dokumentuar rezulton të jetë deri ne 3,000 litra në ditë, e cila, edhe duke hamendësuar një popullsi të Tiranës deri në 1 milionë, do të siguronte 260 litra për person në ditë. Kjo sasi uji është e mjaftueshme për tju përgjigjur kërkesave familjare dhe jo-familjare të qytetit.

Sistemi i furnizimit me ujë është i vjetër dhe punon nën kapacitetin e projektuar, ndërkohë që ka dhe shumë humbje ne rrjet. Keto humbje vleresohen ne rreth 45% te sasise qe leshohet ne rrjetin e shperndarjes. Shifra ka nevojte te saktosohet, mbasi nuk disponohet informacion i plote i lidhjeve ilegale per perdorim shtepiak dhe vaditje. Ka te dhena qe ne disa puse te ceket, uji nentokesor eshte i ndotur. Gjithesesi shifra e humbjeve mendohet te jete e larte.

Ka plane për ngritjen e një ndërmarrje të re të ujësjellësit, e cila do të mbulojë të gjithë rajonin e Tiranës. 100 % e saj do të jetë pronë e Bashkisë së Tiranës, dhe e nennjesive bashkiake te saje sebshku me nennjesite qe kane qene dikure komuna e jane kthyer nen Nennjesi Bashkiake.

Uji sigurohet me ndërprerje dhe sistemi operon me presion të ulët. Ndërkohë që një gjë e tillë ul humbjet, ajo nxit në të njëjtën kohë përdorimin e pompave të ujit për furnizim shtëpiak, nderhyrje qe, deformojne funksionimin hidraulik të sistemit. Shumë shtëpi dhe vecanerisht godinat shumekatshe te ndertuara dy dekadat e fundit, kanë depozitat e tyre vetjake që sigurojnë një furnizim *de-facto* 24 orësh.

Monitorimi i cilësisë së ujit në lumenjtë kryesorë të Shqipërisë kryhet nga disa institucione shkencore, ne vartesi te te MTM, MSh, METE dhe Akademise se Shkencave. Cilesia e ujit te pishem, perfshire aspektin bakterologjik monitorohet nga Ministria e Shendetesise, permes Drejtorive te Shendetit Publik ne Rrethe. Ndërmarrja e Ujësjellësit të Tiranës është gjithashtu përgjegjës edhe për furnizimin me ujë të 105 fshatrave rreth Tiranës, Bashkinë e Vorës, Kamzën dhe Kërrabën. Në këto fshatra jetojnë rreth 200,000 banorë, por vetëm rreth 63,000 kanë kontratë me Ndërmarrjen.

Kjo ndodh kryesisht për arsye se:

- Rrjeti nuk e furnizon të gjithë zonën, shumë shtëpi kanë sistem privat të furnizimit me ujë me puse private, ose u mungon furnizimi me ujë;

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

- Përdoruesit furnizohen, por me lidhje ilegale, shpesh ngaqë ndërtimi i shtëpisë është bërë në mënyrë informale;
- Sistemi i furnizimit me ujë është i vjetër dhe nuk punon.

Për sa kohë furnizimi me ujë i Tiranës vazhdon të jetë me ndërprerje, do të vazhdoje të jete prezent rreziku për shëndetin për shkak të ndotjes kryesisht bakteriale të ujit. Klorifikimi kryhet në impiantin e trajtimit të ujit ose depozitat e ujit të pishem dhe në pergjithesi uji karakterizohet nga teprice klori si mase preventive për të parandaluar ndotjen bakteriale. Ka patur raste, sidomos në stinën e nxhete, të semundjeve gastro-enterike, por mungojnë evidencat që të mund të percaktojnë lidhjen ndërmjet ujit të ndotur dhe semundjes.

5.3. Faktoret Klimaterik të zonës së ndërtimit

5.3.1. Klima

Hapësira e Bashkisë Tiranë përfshihet në zonën klimatike mesdhetare fushore të Shqipërisë. Klima e kësaj zone karakterizohet nga dimra të butë e të lagët dhe vera të nxehta e të thata.

5.3.2. Diellzimi

Një nga elementet bazë që karakterizon klimën e një zone është regjimi i diellzimit, i shprehur me anë të numrit të ditëve të kthjellta e të vranëta.

Për zonën në studim, numri i ditëve të kthjellta luhet nga 6÷7 dite në muajt e dimrit deri në 16÷19 dite në muajt e verës.

Mesatarisht gjatë vitit vrojtohen rreth 1÷2 dite të vranëta në periudhën e verës dhe 10÷12 dite të tilla gjatë e dimrit.

Për hapsirën e Bashkisë Tiranë rezulton se vlerat mujore të rrezatimit të përgjithshëm luhet nga 135,6 kal/cm² në muajin dhjetor deri në 570 kal/cm² në muajin korrik.

Shifrat tregojnë një potencial të konsiderueshëm të energjisë diellore për zonën në studim, element ky shumë i favorshëm për zhvillimin ekonomik të zonës.

Temperatura e ajrit


Një element shumë i rëndësishëm në karakterizimin e klimës së një zone të caktuar është regjimi i temperaturave. Hapsira e Bashkisë Tiranë paraqitet thuhetse homogjene për sa i përket regjimit të temperaturave. Temperatura mesatare vjetore luhet nga 15 deri 16 °C. Janari është muaji më i ftohtë i vitit. Ai karakterizohet nga luhetje të temperaturës 6.6 ÷ 8.3 °C. Gjatë muajit më të ngrohtë, korrikut, temperatura mesatare luhet nga 30 ÷ 34 °C.

5.3.3. Reshjet

Reshjet në hapsirën e Bashkisë Tiranë arrijnë në 1200 mm në vit. Këto vlera janë relativisht jo të larta krahasuar me mesataren vjetore në rang vëndi që është rreth 1450 mm.


Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
 Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, Iyrje e lustrim i makinave.

Sasia më e madhe e reshjeve bie gjatë periudhës së ftohte të vitit, duke arritur kulmin në muajin nëntor me 13-14 % të reshjeve vjetore, ndërsa muaji me i thatë i vitit është korriku me 3 % të reshjeve vjetore.



5.3.4. Era

Kurora e formuar nga kodrat dhe malet që kufizojnë hapsirën Tiranë – Krujë bën që drejtimet mbizotëruese të erës jene veriperëndimi dhe juglindja. Për të njëjtat arsye, shpejtësitë mesatare të erës janë me të vogla nga drejtimet lindje e verilindje.



Trëndafili i erës, vendmatja Tiranë

5.4. Burimet ujore

Tirana ka burime të mjaftueshme ujore për tju përgjigjur kërkesave aktuale dhe perspektive. Kryeqyteti furnizohet, nga katër burime uji sipërfaqësore dhe rreth tetë burime nëntokësore. Burimet sipërfaqësore mbulojnë rreth 50% të furnizimit në vitet e thata, e deri në 80% në vitet e lagështa.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, Iyrje e lustrim i makinave.

Rezerva aktuale e dokumentuar rezulton të jetë deri në 3,000 litra në ditë, e cila, edhe duke hamendësuar një popullsi të Tiranës deri në 1 milionë, do të siguronte 260 litra për person në ditë. Kjo sasi uji është e mjaftueshme për tju përgjigjur kërkesave familjare dhe jo-familjare të qytetit. Sistemi i furnizimit me ujë është i vjetër dhe punon nën kapacitetin e projektuar, ndërkohë që ka dhe shumë humbje në rrjet. Keto humbje vleresohen në rreth 45% të sasise që leshohet në rrjetin e shpërndarjes. Shifra ka nevojë të saktësohet, mbasi nuk disponohet informacion i plote i lidhjeve ilegale për përdorim shtëpiak dhe vaditje. Ka të dhena që në disa puse të ceket, uji nëntokësor është i ndotur. Gjithesesi shifra e humbjeve mendohet të jete e larte.

Ka plane për ngritjen e një ndërmarje të re të ujësjellësit, e cila do të mbulojë të gjithë rajonin e Tiranës. 70% e saj do të jetë pronë e Bashkisë së Tiranës, ndërsa pjesa tjetër pronë e komunave përreth.

Uji sigurohet me ndërprerje dhe sistemi operon me presion të ulët. Ndërkohë që një gjë e tillë ul humbjet, ajo nxit në të njëjtën kohë përdorimin e pompave të ujit për furnizim shtëpiak, nderhyrje që, deformojnë funksionimin hidraulik të sistemit. Shumë shtëpi dhe vecanerisht godinat shumëkatshe të ndertuara dy dekadat e fundit, kanë depozitat e tyre vetjake që sigurojnë një furnizim *de-facto* 24 orësh.

Monitorimi i cilësisë së ujit në lumenjtë kryesorë të Shqipërisë kryhet nga disa institucione shkencore, në varësi të të MMPAU, MSh, METE dhe Akademise së Shkencave. Cilësia e ujit të pishem, përfshirë aspektin bakterologjik monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë, përmes Drejtorive të Shëndetit Publik në Rrethe. Ndërmarrja e Ujësjellësit të Tiranës është gjithashtu përgjegjëse edhe për furnizimin me ujë të 105 fshatrave rreth Tiranës, Bashkinë e Vorës, Kamzën dhe Kërrabën. Në këto fshatra jetojnë rreth 200,000 banorë, por vetëm rreth 63,000 kanë kontratë me Ndërmarrjen.

Kjo ndodh kryesisht për arsye se:

- rrjeti nuk e furnizon të gjithë zonën, shumë shtëpi kanë sistem privat të furnizimit me ujë me puse private, ose u mungon furnizimi me ujë;
- përdoruesit furnizohen, por me lidhje ilegale, shpesh ngaqë ndërtimi i shtëpisë është bërë në mënyrë informale;
- sistemi i furnizimit me ujë është i vjetër dhe nuk punon.

Për sa kohë furnizimi me ujë i Tiranës vazhdon të jetë me ndërprerje, do të vazhdoje të jete prezent rreziku për shëndetin për shkak të ndotjes kryesisht bakteriale të ujit. Klorifikimi kryhet në impiantin e trajtimit të ujit ose depozitat e ujit të pishem dhe në përgjithësi uji karakterizohet nga teprica klorigjate si mase preventive për të parandaluar ndotjen bakteriale. Ka patur raste, sidomos në stinën e nxhete, të semundjeve gastro-enterike, por mungojnë evidencat që të mund të percaktojnë lidhjen ndërmjet ujit të ndotur dhe semundjes.

Çështje Mjedisore që Lidhen me Ujin e Pijshëm

Ka raste kur cilësia e ujit kompromentohet kryesisht nga ndotjet që pëson në linjat e transmetimit (ndotja nga ujrat e zeza, për shkak të intersektimeve të shumta të tubacioneve të ujit të pishem me ato të ujrave të zeza);

Përdorimi për qëllime të tjera veç përdorimit familjar, është i madh duke ulur sasinë e nevojshme për popullsinë; Burimet ujore nëntokësore, sidomos ato deri në 20 m thellësi janë të rrezikuara nga ndotja sipërfqësore për shkak të përshkueshmërisë së lartë të shtresave mbrojtëse.

5.4.1. Cilesia e ujrave

- Impakte te gjeteshme

Lumi i Lanes ndodhet ne nje distance 0.5 km nga blloku i studimit, L.Lanes eshte rrejedha me e afert e ujrave. Edhe pse ne distance te mjaftueshme per tu mos u prekur nga impaktet mjedisore kjo nuk eshte e mundur pasi te gjitha ujar urban shkakohen ne rrjetin qendror te zones per tu derdhur ne Lmin e Lanes.

Me ndotjen e cilese se ujravete Lumit te Lanes ne jemi para nje rreziku te zinxhirit ushqimore.

5.4.2. Burimi i impaktit dhe niveli i impaktit

- ✓ Rrjeti i amortizuar i sistemit te kanalizimeve rrit prpabilitetin e imapketve nga aksedenete me carje apo bllokim te tubacineve duke krijuar perhapje te baktereve dhe aromave te pakendeshme ne zone (ky vleresohet impakt aksidental)
- ✓ Ujrat urban te cilet do te derdhen ne Lumin Lana
- ✓ Prishja e cilesise se ujrave ne lumin lana nga derdhja e ujrave urban te patrajtuar
- ✓ Aroma te pakendeshme gajte sitenes se veres pergjate kesaj rrjedhe
- ✓ Prishja e cilesise se ujrave pergjate gjithë rrjedhes se ketij lumi deri ne Detin Adriatik
- ✓ Ndryshim i faunes karakteristike lumore per ta kthyer ate faune te pershtateshme per te jetuar ne ujar te ndotura

- *Impakte te priteshme*

Nga zbatimi i planit te studimit nuk ndikohet cilësia e ujrave.

Duhet te meren masa per përmirësimin e rrjetit te ujrave urbane si dhe te parashkikohen impjante per paratjartimin e ketyre ujrave para derdhjes se tyre ne **Lumin e Lanes**.

5.5. Ndotja e tokes

Aktivitetet e kaluara dhe te sotme ekonomike shpesh kane ndikuar ne ndotjen e tokes ku keto aktivitete zhvillohen.

Ndotsit me te zakonshmit toksik perfshijne metalet dhe perbersit e tyre, kimikatet organike vajrat dhe bitumi, pesticidet, gazrat shperthyes, materialet e djegshme, asbesti dhe materjale te tjera te rrezikshme. Keto substance zakonisht rrjedhin nga hedhjet e prodhimeve industrial dhe mbetjet shtepiake ne vend depozitim apo vendgrumbullim te pakontrolluar.

- Ndotjet e tokes nga metalet e renda
- Ndotja e tokes nga pesticidet
- Ndotja e tokes nga nitratet dhe fosfatet
- Ndotja e tokes nga lendet radioactive.

Ekzistenca e vendgrumbullimeve te mbetjeve te paligjshme eshte nje nga problemet Mjedisore qe meriton vemendjen me te madhe sot. Kosto e riperimit te ketyre zonave te ndotura llogaritet me shum se 100 milion euro.

5.6. Cilesia e ajrit

Mbyllja e shumë prej industrive ne Bashkine Tirane ka pasur një efekt pozitiv për sa i takon cilësisë së ajrit. Megjithatë, zhvillimet ekonomike dhe sociale pas vitit 1991, vecanerisht rritja e numrit te automjeteve dhe veprimtarive ndërtuese kanë shkaktuar një ndotje serioze të ajrit . Ne menyre te permbledhur po rendisim disa shifra qe lidhen e ritmin e ritjes se numrit te makinave dhe cilesin e tyre te cilat kane ndikuar ne cilesin e ajrit te qyteteve :

- Rritja e lartë dhe përdorimi i çdokohshëm i makinave private;
- Shumica e këtyre automjeteve janë më shumë se 15 vjeçare dhe nuk janë në përputhje me Euro I apo II;
- Rreth 70% e tyre punojnë me naftë;

Një tjetër problem qe lidhet me cilesin e ajrit eshte edhe cilesia e karburanteve qe perdorin automjetet. Benzina dhe rreth 80% e naftës importohet, ndërkohë që në Shqipëri prodhohet edhe naftë e cilësisë së ulët. Që nga viti 2006, në treg ka benzinë pa plumb. Nafta e prodhuar ne vend ka nje permbajtje sqfurit prej 350 ppm dhe synohet te zbriste në 10 ppm në vitin 2011, vlere qe eshte në përputhje me normat e BE-së. Nafta e cilësisë së ulët, e prodhuar lokalisht, formalisht destinohet të përdoret në zonat rurale. Rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë lejojnë gjithashtu importimin e naftës me cilësi të ngjashme me atë të prodhuar lokalisht. Shumë gjeneratorë me naftë që përdoren për të kompensuar ndërprerjet e energjisë janë gjithashtu kontribues në këtë cilësi të dobët të ajrit, mbasi punojnë me naftë te cilesise se dobet. Megjithate lidhur me keta te fundit, ndikimi i tyre ne cilesin e ajrit te qytetit te Tirane perfshire zhurmat, eshte minimal mbasi furnizimi me energji elektrike gjate vitit 2011 dhe ne vazhdim per qytetin e Tiranës ka qene ne pergjithesi pa nderprerje, per pasoje përdorimi i gjeneratorëve nuk ka qene ne pergjithesi i nevojshem.

Një çështje tjetër madhore e cilësisë së ajrit ka lidhje me veprimtaritë ndërtuese. Tabela në vijim jep nivelet PM10 (shprehur ne $\mu\text{g}/\text{m}^3$), në pjesë të ndryshme të qytetit. PM10 është sasia ne peshe e grimcave me diameter deri ne 10 mikron (μ) në një metër kub ajër.

Ndërtimi kontribuon në një masë të madhe në përqendësimin e cilësisë së ajrit qytetin e Tiranës. Ndërtimi rrit gjithashtu dhe ndotjen nga automjetet, si rezultat i qarkullimit të shumë automjeteve te renda dhe transporti.

5.6.1. Burimi i emetimeve ne cilesine e ajrit

- ✓ Emetimi i gazeve nga djegia e karburantit te automjeteve qe qarkullje ne brendesi te objektit dhe perreth tij
- ✓ Kalimi i mjeteve ne cdo hapsire te ketij objekti
- ✓ Rritja progresive e numrit te automjeteve
- ✓ Cilesia e dobet e karburantit
- ✓ Afersia me rrugen e Dibres
- ✓ Infrastruktura e demtuar ne rruget e brendeshme
- ✓ Punimet e ndertimit te kryera nga kompanite apo indivite te vecante ne pronat e tyre
- ✓ Mungesa e parqeve
- ✓ Gjendja e dobet e kontenjereve te cilet gjenerojne aroma te pakendeshme sidomos ne ditet e nxehta

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
 Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

- Masat ruajtën e cilësisë së ajrit

Me zbatimin e strategjisë së hartuar paralelisht do të zbatohen masat për evitimin e impakteve në cilësinë e ajrit.

- Në ditë e nxehta spërkatje të rrugicave me ujë
- Mbjellja e sa më shumë pemëve dhe krijimi i miniparqeve
- Permiresimi i infrastrukturës rrugore
- Evitimi i përdorimit të gjeneratorëve në ambjentete të hapura

5.6.2. Analiza e ndotjes në qytetin e Tiranë

Përmbajtja e fraksioneve PM10 e PM2.5

Në tabelën dhe figurë janë paraqitur vlerat ekstremale dhe mesatare mujore të fraksionit PM10 dhe PM2.5 gjatë periudhës së verës dhe dimrit.

Tabela Vlerat e fraksioneve PM në stacionin urban Tiranë

µg/m ³	Gusht		Dhjetor	
	PM 10	PM 2,5	PM 10	PM 2,5
Max	119.3	23.0	90.2	45.1
Min	20.4	6.5	19.7	15.9
Mesatarja	53.4	12.6	46.1	28.8

Verat ekstremale dhe mesatare mujore të fraksioneve PM10 dhe PM2.5 në stacionin Tiranë

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se vlerat mesatare mujore të fraksionit PM10 gjatë stinëve të ndryshme janë të afërta (53 µg/m³ në verë dhe 46 µg/m³ në dimër) dhe pranë vlerës të kufirit të lejuar (50 µg/m³). Megjithatë numri i ditëve gjatë të cilave vlera kufi tejkalohet (50% të ditëve në verë dhe 30% në dimër) është mjaft më i lartë se norma e lejuar (~10% të ditëve).

Vlera mesatare mujore e përmbajtjes së fraksionit PM2,5, që përbëhet nga grimca të imta me rrezikshmëri të lartë pasi depërtojnë në rrugët e frymëmarrjes, gjatë stinës së verës është e ulët (12.6 µg/m³) dhe në rreth 15 % të ditëve tejkalohet vlera prej 20 µg/m³. Gjatë dimrit vihet re një rritje e konsiderueshme si e vlerës mesatare mujore të fraksionit PM2,5 (28.8 µg/m³) ashtu dhe numri i ditëve (75%) gjatë të cilave tejkalohet vlera prej 20 µg/m³. Rritja e përmbajtjes së fraksioneve PM10 dhe sidomos atij PM2,5 gjatë stinës së dimrit është një fenomen i njohur që lidhet me zvogëlimin e lartësisë së inversionit të temperaturës në atmosferë. Ky efekt është më pak i dukshëm në matjet të muajit Dhjetor për PM10 për shkak të numrit të madh të ditëve me reshje gjatë periudhës së mbledhjes së mostrave.

Përgjithësisht, raporti midis të dy fraksioneve (PM10/PM2,5) nuk është konstant dhe kjo mund të shpjegohet me ndikimin e kushteve meteorologjike mbi shpejtësinë e precipitimit të grimcave me dimensione të ndryshme. Kjo shfaqet edhe në matjet e bëra ku përmbajtja e fraksionit PM2,5 i afrohet shumë asaj të fraksionit PM10 sidomos në ditët me reshje të periudhës së dimrit.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, Iyrje e lustrim i makinave.

Fakti që përgjithësisht përmbajtja e elementeve në fraksionin PM_{2,5} është e ulët të bën të mendosh që ai përbëhet kryesisht nga produkte të djegies së karburanteve, mbeturinave apo lëndëve djegëse të ngurta.

Në përfundim mund të themi se situata e ndotjes nga PM₁₀ në stacionin urban të Tiranës është mesatarisht pranë kufijve të lejuar por përbën shqetësim numri i ditëve gjatë të cilave përmbajtja është më e lartë se norma.

5.6.3. Përbërja elementore e fraksionit PM₁₀

Në mostrat e analizuar janë përcaktuar elementet K, Ca, Ti, V, Cr, Mn, Fe, Ni, Cu, Zn, Br, Rb, Sr dhe Pb. Ndër këta K, Ca, Ti, Mn, Fe, Ni, Cu, Zn e Pb kanë qenë prezent në mbi 95 % të mostrave, ndërsa V, Cr, Rb dhe Br janë përcaktuar jo në të gjitha mostrat.

Vlerat mesatare mujore të përmbajtjes së elementëve në fraksionin PM₁₀ në stacionin Tirane

µg/m ³	K	Ca	Ti	V	Cr	Mn	Fe	Ni	Cu	Zn	Br	Rb	Sr	Pb
Gusht	437.9	4611.1	35	10	10.5	16.6	743.9	7.4	7.4	25.9	5.8	4.6	7.9	11
Dhjetor	566	6656.1	44.1	4.8	9.8	31.1	848	11	15.4	28.6	4.4	6.6	13.6	14.3

Në tabelë dhe në figure janë paraqitur rezultatet statistikore për grupet e mostrave të fraksionit PM₁₀ të mbledhura në secilin muaj, në të cilat janë paraqitur vlerat mesatare mujore të përmbajtjes së elementeve (ng/m³). Kjo ndihmon që të kemi një përfytyrim më të mirë mbi kufijtë e shpërndarjes së secilit element të përcaktuar. Ndryshimet që vihen re në rezultatet e mostrave të mbledhura ndikohen nga kushtet e motit dhe trafiku i dendur dhe i çrregullt në atë zonë.

Ndër elementët e përcaktuar në fraksionin PM₁₀ përqendrim më të lartë paraqesin elementet Ca, Fe, K e Ti të cilët së bashku me Mn e Sr janë karakteristike për grimcat e dheut. Vlerat e larta të këtyre elementeve konfirmojnë prezencën relativisht të lartë të pluhurit tokësor në fraksionet PM₁₀ të mbledhura.

Vlerat e përqendrimeve të matura për metalet toksike V, Cr, Mn, Ni, Cu, Zn dhe Pb janë mjaft të ulëta, bile edhe vlerat maksimale të përcaktuara janë mjaft më të ulëta se nivelet e lejuar. Duhet theksuar se përmbajtja e elementëve në fraksionin < 2,5 µm (PM_{2,5}) është përgjithësisht mjaft e ulët. Edhe në këtë rast përmbajtje më të lartë paraqesin elementët me prejardhje tokësore Ca dhe Fe ndërsa elementet toksikë kanë përqendrime mjaft të ulëta. Këto të dhëna tregojnë se situata e ndotjes me metale toksike në stacionin e Tiranës nuk është problematike, duke qenë se përqendrimet e të gjithë metaleve janë mjaft më të ulët se normat e lejuara, dhe nga ana tjetër ajo paraqitet e stabilizuar pasi nuk vihet re ndryshim i dukshëm nga vitet e mëparshme.

5.7. Zhurmat

Ndotja zanore është veçanërisht e rëndë në vendet në zhvillim. Ajo i detyrohet kryesisht trafikut rrugor dhe në zonat dense (të dendura) të trafikut rrugor, nivelet e presionit akustik gjatë 24 orëve mund të arrijnë 75-80 dB(A). Gjithnjë e më shumë ndotja akustike është duke u rritur dhe duke u shfaqur si një

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

rrezik mjedisor “i dukshëm”. Efektet e zhurmave grumbullohen tek individi si ngjarje zhurme, me efekte negative në dëgjim, psikike dhe mënyrën e jetesës.

Zhurma ndihet në nivel individi, por kur rrezikon një grumbull individësh atëhere përbën një çështje serioze të shëndetit publik. Ndryshe nga shumë probleme të tjera të mjedisit, ndotja nga zhurma vazhdon të evoluojë dhe krijon një numër ankesash në rritje të asaj pjese të personave që janë të ekspozuar.

Rritja e ndotjes zanore është e pasuportueshme sepse ajo ka efekte negative mbi shëndetin, në të njëjtën kohë direkte dhe të grumbulluara (të akumuluar).

Presioni akustik është një matje bazë e vibracioneve të ajrit që përbëjnë zhurmën. Meqënëse intervali i presionit akustik, që auditori human mund të zbulojë (dallopë), është shumë i gjerë këto nivele i matim me një shkallë logaritmike me njësi decibel (dB). **Niveli i zhurmave urbane (L_{Aeq}): është niveli i vazhduar ekuivalent i presionit akustik të ponderuar (A0), të prodhuar nga të gjithë burimet e zhurmave që ekzistojnë në një vend të caktuar dhe gjatë një kohe të caktuar.**

Monitorimi i zhurmave urbane i kryer nga Instituti i Shëndetit Publik ka për qëllim matjen e nivelit të ndotjes akustike, në pikat e monitorimit të 8 qyteteve kryesore të vendit tonë, për të dhënë mundësinë që të gjykohej mbi masën e ekspozimit të popullatës ndaj zhurmave. Kur niveli i zhurmave është rreth 65 dBA, gjumi bëhet shqetësim serioz dhe shumica e popullatës bezdisen.

Në këtë rast, zhurma në komunitet, bëhet një problem i vërtetë i shëndetit mjedisor. Edhe në vendin tonë, zhurma është një nga rreziqet mjedisore, që vazhdon të evoluojë dhe mund të krijojë probleme tek ajo pjesë e personave që janë të ekspozuar. Veçanërisht, **ndotja nga trafiku rrugor** është bërë problematik dhe mjaft shqetësues. Një tjetër ndikim, ka pasur dhe prania në distanca të konsiderueshme e burimeve alternative të përkohëshme të energjisë si: gjeneratorët.

Niveli mesar i zhurmës nëpër qytete sipas L_{Aeq}/D/N

Qytetet	L _{Aeq} /Ditën	L _{Aeq} /Natën
Tiranë	70,1	59,5
Tirane	67,2	51,6
Fier	62,7	45,9
Shkodër	62,6	42,2
Vlorë	62,5	45,5
Sarandë	63,6	46,1
Korçë	60,4	44,9
Elbasan	61	54,1

6. Alternativat ne lidhjen me zgjedhjen e vendit te Instalimit, teknologjia e perdorur

- ✚ Pronesia private e truallit
- ✚ Vendi eshte i pershtateshem per kryerjen e aktivitetit ne fjale, pasi eshte afer qendrave te banuara dhe nuk paraqet shqetesime per popullsine e zones.
- ✚ Shoqeria « BRILAND LINE » shpk ka ndertuar zyrat, magazinat perkatese per qellimin final qe eshte dhene nga ana e ketij projekti.
- ✚ Aktiviteti do te zhvillohet ne nje zone te miratuar si Njesia Bashkjake Nr.1. Bashkia Tirane.
- ✚ Aktiviteti nuk krijon probleme sociale e mjedisore
- ✚ Rreth objektit, ne distance nga ai, zhvillohen aktivitete te tjera ekonomike industriale te te njejtit lloj.
- ✚ Objekti eshte ne afersi te Rrugës "Ali Demi" gje qe ndikon pozitivisht ne sektorin e sherbimeve ne kete qytet.
- ✚ Rruget hyrje e dalese dhe lidhja e tyre me rruget kryesore siç eshta rruga "Ali Demi" plotesojne kerkesat e rregullores, te qarkullimit dhe te sjelljes ne rruge.
- ✚ Ojekti ka nje largesi prej 10 m me rrugen dytesore e cila lidhet me rrugen kryesore te lartepemendur duke plotesuar kushtet teknike per levizjen e lire te mjeteve dhe ne rast avarie te futjes ne objekt te mjeteve te emergjences.

Per sa siper ndertimi dhe ushtrimi I aktivitetit te Servisit te makinave dhe impjanti I lyerjes dhe llustrimit eshte alternative me e mire per kete zone.

Teknologjia e perdorur ne kete servis eshte bashkekohore me paisje te ardhura nga vendet e Bashkimit Evropjan e konkretisht te ardhur nga Italia.

7. Masat per parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve

7.1. Menaxhimi i Mbetjeve

Politikat për mbrojtjen e mjedisit, përmirësimi i infrastrukturës institucionale, forcimi i rolit dhe bashkëpunimit midis institucioneve qendrore dhe lokale, ndërgjegjësimi i publikut dhe angazhimi i të gjithë aktorëve të interesuar për administrimin e mbetjeve kanë qenë një nga objektivat më kryesore dhe të rëndësishme të legjislacionit dhe strategjisë kombëtare. Rëndësia e synimi kryesor është zbatimi i plotë i tyre duke filluar me parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve, riciklimin, trajtimin e tyre për shfrytëzimin e nehtësisë apo energjisë për qëllime industriale, shtëpiake etj, dhe depozitimi i tyre në landfill. Një vend të rëndësishëm në zbatimin e legjislacionit tonë dhe direktivave të Bashkimit European ka trajtimi dhe shfrytëzimi i mbetjeve industriale. Mbetjet industriale përveç nevojës dhe rëndësisë së

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

riciklimit dhe përdorimit të tyre, kanë vlera ekonomike në shfrytëzimin e energjisë termike të gjeneruar gjatë procesit të incinerimit (djegjes).

MMT ka miratuar të Strategjisë Kombëtare të mbetjeve dhe Ligjit për Administrin e Integruar të Mbetjeve për periudhën 2010 – 2025. Zbatimi i tyre dhe një seri vendimesh të reja të KM, do të japë një shtysë përpara trajtimit të integruar të mbetjeve duke i shmangur ato në venddepozitimin e tyre, duke zbatuar objektivat e Direktivës të KE mbi Landfillin

7.1.1. Mbetjet urbane

- Impakte të gjeteshme

Vendi yne nga viti në vit po rrit interesin për përmirësimin e sistemit të mbledhjes dhe menaxhimit të mbetjeve urbane.

Si impakt i gjetshme në këto nën-njesia bashkiake do të çilesojmë mungesën e sistemit të seleksionimit të mbetjeve që në origjinë, vendosjen e kontenjereve të pershteshme për këto. Duhet të theksojmë se kjo i përket injektivave të qeverisjes qendore, sigurisht që plani i jone vendore mer për sipër propozimin për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve.

- Masat për përmirësimin e sistemit të menaxhimit

Në këto nën-njesi vendore problemi i mbetjeve nuk haset si problematik e rëndë pasi një pjesë dominante e komunitet kanë informacion të lartë për mbajtjen pastër të mjedist ku jetojnë, por lind dëshira dhe nevojë që kjo Njesi vendore të përmirësojë akoma më tej këto sisteme në bashkëpunim me organet vendore.

- ✓ Vendosja e pikave ku do të vendosen kontejnerët e grumbullimit të mbetjeve
- ✓ Pergatitja e reklamave dhe fletëpalosjeve për ndërgjegjësimin e qytetarëve
- ✓ Propozimi për pastrim me të shpeshtë të kontejnerëve dhe larjen e tyre me të shpeshtë gjatë stinës së verës.

Mbetjet urbane, hidhen në kosha që ndodhen në brendësi të servisit të cilët janë të mbuluara me qese të zeza. Koshat e mbeturinave zbrazen nga punonjësit sanitare 2 herë në ditë. Në përfundim të ditës koshat e mbeturinave mbeten bosh. Mbeturinat nga koshat e vegjel që janë në brendësi të lokalit hidhen në një kazan i cili shkarkohet në kontejnere të në vendin e caktuar nga Bashkia e Tiranës. Mbeturinat ndahen sipas natyrës së mbeturinës si leter, qelq dhe mbetje organike. Evadimi i tyre bëhet nga Kompania e Pastrimit për në vendin e kompostimit (Sharre). **Rreth 0,5 ton/vit**

7.1.2. MBETJET E NGURTA

Tipi: Amballazhe të ndryshme mbetje urbane nga punonjësit që punojnë, etj.

Pjesë ndërrimi të vjetra që hiqen nga pas riparimit të makinave

Sasia 2,5 ton/vit.

Burimi: nga amballazhe të ndryshme si dhe heqja e pjesëve të demtuara të makinave

7.1.3. Mbeturinat metalike.

Qe dalin nga ndërrimi i pjesëve të demtuara grumbullohen në një vend të caktuar dhe dërgohen një herë në muaj në një pikë për grumbullim skrapë **2 ton/vit**

7.2. Mbetjet e lengeta.

Vaji i nderruar i motorreve pasi terhiqet nga nje pajisje bashkekohore depozitohet ne bidona kauçuku dhe me pas tregetohet per subjekte private qe e perdorin ate per trajtimin e lendes drusore per ndertim.

Brenda 1 muaji, parashikohet te depozitohen afersisht 10 - 30 litra vaj.

Ujrat e perdorura e te ngarkuara me vajra e tretesa lares do te trajtohen ne vaska dhe depozitohen ne bidona.

Pronarit ju la per detyre ndertimi i separatorit ndares.

8. Masat per perdorimin eficient te energjise

8.1. Impakte dhe masat per mbrojtjen e komunitetit

▪ *Impeket e gjendeshme*

Ne Bashkine Tirane dominojne ndertimet pas viteve '90 per shkak te historisë se rëndësishme qe ka kjo zone. Impakte e gjendeshme te cilat janë shqetuese per komunitetin janë:

- ✓ Cilesia e ajrit
- ✓ Prezenca e larte e zhurmave
- ✓ Gjendja e rrugëve te brendeshme
- ✓ Mungese e nje sistemi te mirefillte te menaxhimit te mbetjeve (si psh seleksionimi i mbetjeve qe ne origjine).
- ✓ Tipologjia e ndertimeve dhe zbatimi i distancave te banesave nga njera tjetra.

8.1.1. Pasojat ne komunitet:

- ✓ Ne shume raste krijimi i problemeve ne shëndet per shkak te gazeve te emetuara ne karbuarantete automjetve qe lëvizin dendur ne rrugicat e zones duke krijuar probleme ne rrugët e frymëmarrjes, mushkëritë e te tjera ne varësi te imunitetit te personave.
- ✓ Zhurmat dëmtojnë sitemin e dëgjimit dhe rrisin nivelin e stresit.
- ✓ Rruget e brendeshme ne nivel jo te kenaqeshem krijojnë trafik, per pasoje emetim me te larte te gazeve nga djegia e karburanteve, pluhure zhurma.
- ✓ Aroma te pakendeshme nga kontejnerët sidomos ne stinën e veres
- ✓ Tipologjia e ndertimeve dhe distancat e banesave nga njera tjetra krijon konflikete mes komunitetit, si pasoje e ndryshimit ne pamjes se tyre si dhe rritja e numrit te popullsisë ne kete zone.

Hartimi i planit urbanistik ka per qellim formatimin e zones duke vendosur kriteret urbane dhe mjedisore, ku gjithkush qe do te jetoje ne kete zone ta ndjej veten te sigurt duke ditur se cfar ndërtimesh do te behen përreth objektit te tij.

▪ *Impaktete e priteshme*

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

Keto impakte hasen gjate zbatimit te palnit ne terren, kryesiht këto impakte vine nga punimet ndertimore. Duke rritur mbetjet inerte (te ndertimit), zhurmat nga uatomjete e punës etj. Ajo qe vlen te theksohet eshte se ky impakt eshte mjaft afatshkurtër dhe per me shume eshte impakt i priteshem.

Plani i hartuar ka impakte pozitive ne komunitet pasi zbatohet ne përmirësim te jetës se qytetareve.

- *Masat qe do te zbatohen per evitimin e impakteve mjedisore dhe strukturore*

Plani i hartuar eshte nje mase mjaft e fuqishme per reduktimin e impakteve ne komunitet.

Masa konkrete:

- ✓ Permireshimi i infrastrukturës se rrugëve te brendeshme te kësaj nen-njesie.
- ✓ Krijimi i hapsirave dhe alternativave per parkim
- ✓ Krijimi i hapsirave te gjelbera
- ✓ Planifikimi i karakterit te ndërtimeve
- ✓ Krijimi i sistemeve me te mira per menaxhimin e mbetjeve urbane

Vnedosja e sisnjalistikave ne te gjithë rrugët dhe zbatimi i lëvizjes me nje karh te rrugicave te

9. Masa te tjere qe rregullojne detyrimet themelore te operatorit

9.1. Sigurimi Teknik ne Autoservis

Gjate ushtrimit te aktivitetit Shoqeria « BRILAND LINE » shpk do te mbaje parasysh qe problemet e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune jane me te rendesishme dhe me te mprehta dhe kerkojne vleresim serioz.

Para se gjithash ne te gjitha operacionet e punes, duke patur parasysh teknologjine dhe makinerite e pajisjet cilesore qe ka ne disponim, jane punesuar specialist me kualifikim te larte profesional.

Me perparesi do te trajtohen disa nga detyrat e meposhtme:

- Ruajtja dhe perdorimi i makinerive e pajisjeve ne standartet teknike te kerkuar e miratuar per kete qellim.
- Te zbatohen me perpikëmeri te gjitha rregullat e mbrojtjes nga zjarri dhe energjise elektrike, duke i shoqeruar me anen figurative.
- Te zbatohen me perpikëmeri te gjitha detyrat dhe masat e percaktuara ne **Akt-Kontrollet** e vendosura per sigurimin teknik e mbrojtjes ne pune nga persona apo subjekte te kualifikuara dhe amortizuara ne kete drejtim.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes ne pune te jene objekt i nje pune te programuar dhe te ndiqen ne vazhdimesi, ku nje kujdes shume te madh te tregohet ne perdorimin e energjise elektrike, pajisjeve, makinerive, rrobave te punes etj.
- Te behet largimi i cdo lloj mbeturine te ngurte apo te lenget gjate funksionimit te kesaj njesie per Autoservis Makinash, per ne vendet e percaktuara nga Pushteti Lokal.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

- Punonjesit duhet te jene te pajisur me libreza shendetesore dhe me uniformat e punes.
- Ambientet e punes duhet sistematikisht te mbahen paster (duke perfshire dhe daljen perpara te kesaj njesie te tortuar)
- Kryerja e instruktimit periodik te punonjesve.
- Ndalimi ne menyre kategorike i futjes te njerezve te ndryshem, ne ambientet e brendshme te njesise, pa qene te autorizuar nga personat pergjegjes.
- Ne procesin e punes se kesaj njesie te kesaj njesie te respektohet i gjithe legjislacioni dhe rregulloret e fushes perkatese duke i dhene perparesi marrjes ne pune punonjesve dhe personelit te kualifikuar.
- Ne te gjitha makinerite dhe pajisjet qe disponon Shoqeria « BRILAND LINE » shpk duhet te punojne vetem ata qe jane te pajisur me leje perkatese per ushtrimin e profesionit te tyre.

Drejtuessit teknik, para fillimit te punes dhe gjate saj, do te kontrolloj dhe kerkoj zbatimin e te gjithe rregullave dhe normave te percaktuara ne te gjitha aspektet e Legjislacionit Shqiptar.

**9.1.1. Sipas legjislacionit dhe rregulloreve parashikohen detyrimet si me poshte:
Detyrimet e punedhenesit**

Punedhenesi vete, duhet tu beje te ditur punemarresve:

- Procesin teknologjik te operacioneve ne teresi ne kete njesi dhe ne menyre specifike te punes ne linjen ku punon.
- Njohjen me pajisjet dhe makinerite qe perdoren ne kete njesi Sherbimi
- Shkaqet e aksidenteve te mundshem dhe masat per menjanimin e tyre.
- Njohjen me rregulloren e sigurimit teknik dhe mbrojtjes ne pune ne Republiken e Shqiperise, akte ligjore dhe udhezime ne zbatim te tyre, te leshuara nga dikastere qe lidhen me to.
- Vecorite e punes ne kete njesi ku do punohet, rregullat teknike dhe te mbrojtjes, per menjanimin e aksidenteve dhe mbrojtjen e makinerive.
- Njohjen me ndihmen e pare shendetesore.
- Me pajisjen e punonjesve me Libreza Shendetesore.
- Vendosjen ne ambientet e punes, ne vende te dukshme, tabela me pajisjet kryesore te rregulloreve.
- Tu krijoje punonjesve kushte te mira pune dhe jetese, mjete mbrojtese, trajtime te ndryshme me kompensim ne vlere ose natyre.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

- Te kryeje instruktim paraprak dhe periodik i punonjesve, Dokumentat sipas formulareve te percaktuar ne rregulloren e sigurimit teknik.

9.1.2. Detyrimet e punemarresit

- Te njoh mire teknologjine ne perdorim per shfrytezimin e pajisjeve dhe makinerive.
- Te njoh dhe zbatoje rregulloret e sigurimit teknik dhe te Mbrojtes ne pune te publikuara nga Inspektorjati i sigurimit Teknik dhe Inspektoriati i Punes.
- Ne asnje rast nuk duhet te punohet pa rrobat e punes e mjetet Mbrojtese. Ne te gjitha rastet e sigurimit teknik te jete prioritare.
- Te dije mire shkaqet e mundeshme, te aksidenteve qe mund te ndodhin ne kete njesi, si dhe masat per eliminimin e tyre.
- Kur konstaton shenja te nje avarie te mundeshme, qe eshte burim aksidenti e mund te jete me pasoja per jeten, ne rradhe te pare, merr masa per eliminimin e tij, nderkohe lajmeron gjithe punonjesit per rrezikun dhe ve ne dijeni pronarin, pergjegjesin e kesaj njesie.
- Duhet te dije te perdori mjetet mbrojtese individuale ne pune.
- Te kete njohuri te mjaftueshme ne dhenien e ndihmes se shpejte ne rast nevojje.

9.2. Organizimi i punes.

Autoservisi do te punoje me dy turne ku do te punoj nje brigade punonjesish me inxhinjeret per çdo repart.

Orari i punes do te jete çdo dite:

ores 08.⁰⁰ der ne oren 21.⁰⁰.

Personeli do te jete i kualifikuar dhe me nje pervoje ne keto sherbime.

10. Monitorimi i planifikuar i shkarkimit nga Instalimi

10.1. Programi i monitorimit te ndikimit ne mjedis

Shoqeria « BRILAND LINE » shpk i ka mundesite financiare dhe stafin drejtues inxhinjeret teknik dhe ka perpiluar programin e monitorimit te ndikimit ne mjedis nga aktiviteti qe kryehet gjate ngritjes dhe venies ne funksion te Autoservisit te makinave.

Me venien ne funksion te linjes se lartpermendur Shoqeria « BRILAND LINE » shpk i ka mundesite e plota qe te zbatoje kete program:

10.2. Programi i monitorimit te ndikimit ne mjedis

Treguesit e monitorimit

Nr.	Elementi i monitorimit	Frekuenca	Pergjegjesi
1	Monitorimi i rregullave te sistemit te mbrojtjes nga zjarri	Periodike	Kompania
2	Monitorimi e cilësisë se ajrit	Periodike	Kompania
3	Monitorimi I Zhurmave	6 muaj	Kompania
4	Monitorimi I shkarkimit te nbetjeve te lengeta e urbane	6 muaj	Kompania
4	Monitorimi i gjendjes se mekanikes dhe mundesit per shtimin e zhurmave ne pune.	Periodike	Kompania

Ne kete aspekt specialistet e punesuar nga Personi Fizik Shefqet ÇOLLAKU do te bashkepunojne me specialistet e institucioneve te specializuara sipas specialisteve per monitorimin e :

- o Monitorimin e shkarkimeve te mbetjeve te lengeta, metaleve dhe mbetjet urbane ne toke.
- o Cilesine e ujrave
- o Cilesine e ajrit
- o Nivelin e intensitetit te zhurmave
- o Etj....

Monitorimi do te kryehet ne perputhje te plot me vendimin e Keshillit te Ministrave "Per Monitorimin e Mjedisit ne Republiken e Shqiperise" date 31.03.2002.

Monitorimi do te kryehet per keto grupe treguesish dhe konkretisht per:

- **Tregues per Autoservisin e makinave do te jene**
 - Relizimi i projektit
 - Treguesit e cilesise se riparimit te mjeteve
 - Treguesit e cilesise se shitjes se pjesve te kembimit .
 - Treguesit e llojshnerise se shitjes se pjesve te kembimit
 - Treguesit e cilesise te tregtimit te vajit te motorrave.
 - Treguesit e cilesise se lyerjes dhe Ilustrimit te makinave
 - Etj.
- **Tregues estetik ekologjik te cilet do te jene:**
 - Relizimi i gjelberimit te planifikuar ne objekt
 - Krijimi i habitatit ne zonen e gjelberuar
 - Vezhgimet ne ndryshushmerine e biodiversitetit
 - Etj

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

- **Treguesit e ndotjeve te cilat do te jene:**

- Te dhenat mbi monitorimin e tokes, duke marre ne konsiderate shkarkimet e mundeshme
- Te dhenat mbi cilesin e ajrit
- Te dhenat mbi monitorimin e ujit
- Te dhena mbi nivelin e zhurmave
- Etj.

Te dhenat e marra nga monitorimi do te dergohen çdo 6- muaj prane Agjensise Konbetare te Mjedisit. Bazuar ne VKM nr.177,date 31.03.2005. "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritesë".

Shoqeria « BRILAND LINE » shpk duhet te beje analizat e ujrave te perdorura te aktivitetit, çdo 3 muaj. Kampionet do te merren ne pranine e Inspektorit te AKM-se dhe te dergohen per analize ne laboratore te çertefikuara te shtetit shqiptar. Rezultatet e analizave i dergohen menjehere nga pronari tek AkM-ja Tirane.

Per mos respektim te normave te shkarkimeve ne ujra, pronari i nenshtrohet sanksioneve ligjore.

Per çdo rast te ndryshimeve potenciale ne mjedis, te paparashikuara, si rezultat i aktivitetit, pronari duhet te marre masa mbrojtese dhe te njoftoje menjehere AkM-ne Tirane

10.3. Permbledhja e keshillimeve me organet e qeverisjes vendore publikun etj.

Bazuar ne kontaktet e marra me oragnet e qeverisjes vendore dhe me dokumentacionin qe disponohet theksojme se ne fjale ka kryer keshillimet dhe konsultimet e duhura me komunitetin e kesaj zone dhe me stafin drejtues te qeverisjes vendore.

10.4. Masat rehabilituese, ne rast ndotje dhe demtimi te mjedisit

10.4.1. Masat per mbrojtjen e mjedisit

Masat per mbrojtjen e mjedisit qe jane mare nga ana e Shoqerise jane:

- Territori i Autoservisit te makinave do te sistemohet dhe te gjelberohet me vegjitacion te larte i cili te jete i pershtatshem per kushtet fitoklimatike te zones
- Te behet pastrimi periodik i makinerive
- Te mirembahen kanalizimet e brendeshme te objektit te lidhura me tubacionin kryesor qe shkarkohen ne kolektorin kryesore.
- Te merren masa per evitimin e pluhrave qe mund te shkaktohen nga levizja e makinave.
- Te merren masa per evitimin e erozionit.
- Te merren masa per grumbullimin, ruajtjen dhe evadimin e sasise se vajrave te perdorur.

Permbledhje Jo Teknike e Ndikimit ne Mjedis
Instalimi: Servis per riparim makinash e paisje motorike, lyrje e lustrim i makinave.

- Te mos lejohet qe vajrat e perdorura te hidhen ne kanalet e ujrave por te dergohen ne kompani te Çertefikuara per grumbullimin e vajrave te perdorur.

10.4.2. Per zbutjen e ndikimit ne mjedis te zbatohen normat ligjore, keto norma ligjore per shkarkimin ne toke, ne ajer dhe ne uje

- Nga aktivitete qe ushtrohen te mos kene ndikim tek njerezit dhe ne mjedis.
- Te kryehet monitorimi peridik i zhurmave dhe i shkarkimeve ne ajer, uje dhe te dhenat et dergohen prane AKM-se Tirane
- Çdo 6-muaj te dergohet informacion i hollesishem mbi nivelin e punimeve te kryera prane AKM-se Tirane.

10.5. **PERFUNDIME**

- ✓ Me e rendesishme per t'u theksuar ne perfundim te ketij raporti te permbledhur te vlersimit te ndikimit ne mjedis eshte se ai i vjen ne ndihme mbrojtjes se mjedisit.
- ✓ Ai i jep vlere ekonomike nje projekti
- ✓ Procesi i riparimit te makinave eshte domosdoshmeri dhe nuk eshte i rrezikshem per shendetin e punonjesve dhe te banoreve te zones, me masat e propozuara
- ✓ Aktiviteti nuk ka ndikime negative ne toke dhe nuk ndikon ne ujrata siperfaqesore e nentokesore
- ✓ Nuk ndikon negativisht ne cilesine ajrit te zones dhe nuk shkakton çlirim ne ajer te substancave kimike
- ✓ Eshte nje proces prodhimi qe punon pa prodhuar mbeturina te ngurta
- ✓ Vendi eshte i pershtateshem psi aktiviteti qe do zhvillohet ne zone te percaktuar industriale, duke mos paraqitur problem per popullsine e zones
- ✓ Ne mbyllje, Aktiviteti nuk ka ndikime te ndjeshme negative ne mjedis ai nuk shkakton ndotje dhe demtim te mjedisit.

Per Shoqerime « BRILAND LINE » shpk

Administratori

Luan Çiba



Tirane 08.03.2021